



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 24

Tiranë – E mërkurë, 17 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 7/2016 datë 4.2.2016	Për pranimin e protokollit për ndryshimin e Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë..... 2247
Vendim i Kuvendit nr. 8/2016, datë 11.2.2016	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazës së të dhënave shtetërore tatimore..... 2271
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 10.2.2016	Për një shtesë në vendimin nr.628, datë 15.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”..... 2272



LIGJ
Nr. 7/2016

**PËR PRANIMIN E PROTOKOLLIT PËR
NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË
MARRAKESHIT QË THEMELOI
ORGANIZATËN BOTËRORE TË
TREGTISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe të nenit 14, të konventës së Vjenës “Për të drejtën e traktateve”, aderuar me ligjin nr. 8696, datë 23.11.2000, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pranohet protokollin për ndryshimin e Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.2.2016

Shpallur me dekretin nr. 9422, datë 11.2.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

PROTOKOLLI

**PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË
MARRAKESHIT QË THEMELOI
ORGANIZATËN BOTËRORE TË TREGTISË
VENDIMI I DATËS 27 NËNTOR 2014**

Këshilli i Përgjithshëm;

Duke pasur parasysh paragrafin 1 të nenit X të Marrëveshjes së Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (Marrëveshja e OBT-së);

Duke kryer funksionet e Konferencës Ministrore në intervalin ndërmjet mbledhjeve në pajtim me paragrafin 2 të nenit IV të Marrëveshjes së OBT-së);

Duke rikujtuar vendimin e Këshillit të Përgjithshëm për të filluar negociatat mbi bazën e

modaliteteve të përcaktuara në shtojcën D të atij vendimi, të miraturar më 1 gusht 2004, si dhe vendimin Ministror të datës 7 dhjetor 2013, për të hartuar një Protokoll të Ndryshimit për të futur Marrëveshjen mbi Lehtësimin e Tregtisë në aneksin 1A të Marrëveshjes së OBT-së (Protokollin);

Duke rikujtuar paragrafin 47 të Deklaratës Ministrore të Dohas, të datës 20 nëntor 2001;

Duke rikujtuar paragrafët 2 dhe 3 të Deklaratës Ministrore të Dohas, shtojcën D të vendimit të Këshillit të Përgjithshëm të gushtit 2004 dhe nenin 13.2 të Marrëveshjes mbi Lehtësimin e Tregtisë mbi rëndësinë e ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit për të ndihmuar vendet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara për të zbatuar dispozitat e Marrëveshjes mbi Lehtësimin e Tregtisë;

Duke mirëpritur njoftimin e Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen, brenda strukturave ekzistuese të OBT-së, të një Faciliteti të Marrëveshjes mbi Lehtësimin e Tregtisë për të menaxhuar mbështetjen që anëtarët dalin vullnetarë t'i ofrojnë OBT-së në përkrahje të ndihmës shtesë për të zbatuar dispozitat e Marrëveshjes mbi Lehtësimin e Tregtisë dhe për të lehtësuar koherencën e ndihmës me shtojcën D plus agjencitë;

Duke marrë në konsideratë Marrëveshjen e paraqitur nga Komiteti Përgatitor mbi Lehtësimin e Tregtisë (WT/L/931);

Duke vënë në dukje konsensusin për të paraqitur këtë ndryshim të propozuar tek anëtarët për pranim;

Vendos si më poshtë:

1. Protokollin që ndryshon Marrëveshjen e OBT-së, bashkëngjitur këtij vendimi, miratohet në këtë mënyrë dhe i paraqitet anëtarëve për pranim.

2. Protokollin në këtë mënyrë do të jetë i hapur për pranim nga anëtarët.

3. Protokollin do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e paragrafit 3 të nenit X të Marrëveshjes së OBT-së.

Anëtarët e Organizatës Botërore të Tregtisë;

Duke in referuar Marrëveshjes mbi Lehtësimin e Tregtisë;

Duke pasur parasysh vendimin e Këshillit të Përgjithshëm në dokumentin WT/L/940, të miraturar në pajtim me paragrafin 1 të nenit X të Marrëveshjes së Marrakeshit, që themeloi



Organizatën Botërore të Tregtisë (Marrëveshja e OBT-së),

bien dakord si më poshtë:

1. Aneksi 1A i Marrëveshjes së OBT-së, pas hyrjes në fuqi të këtij Protokollit, në pajtim me paragrafin 4, do të ndryshohet nga futja e Marrëveshjes mbi Lehtësimin e Tregtisë, siç përcaktohet në aneksin e këtij Protokollit, për t'u vendosur pas Marrëveshjes mbi Masat Mbrojtëse.

2. Rezervimet mund të mos hyjnë në lidhje me ndonjë prej dispozitave të këtij Protokollit pa miratimin e anëtarëve të tjerë.

3. Ky Protokoll hapet në këtë mënyrë për praninë nga anëtarët.

4. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafin 3 të nenit X të Marrëveshjes së OBT-së.¹

5. Ky Protokoll do të depozitohet me Drejtorin e Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Tregtisë, i cili do t'i dorëzojë menjëherë çdo anëtar një kopje të certifikuar të tij dhe një njoftim të secilit praninë të tij në pajtim me paragrafin 3.

6. Ky Protokoll do të regjistrohet në përputhje me dispozitat e nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Gjenevë, më 27 nëntor 2014, në një kopje të vetme në gjuhët angleze, franceze dhe spanjolle, duke qenë secili tekst autentik.

ANEKSI I

PROTOKOLLIT QË NDRYSHON MARRËVESHJEN E MARRAKESHIT QË THEMELOI ORGANIZATËN BOTËRORE TË TREGTISË

MARRËVESHJA MBI LEHTËSIMIN E TREGTISË

Parathënie

Anëtarët,

Duke pasur parasysb negociatat e nisura sipas Deklaratës Ministrore të Dohas;

Duke rikujtuar dhe riafirmuar mandatin dhe parimet e përfshira në paragrafin 27 të Deklaratës Ministrore të Dohas (WT/MIN(01)/DEC/1) dhe

në aneksin D të vendimit të Programit të Punës së Dohas të miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm, më 1 gusht 2004 (WT/L/579), si dhe në paragrafin 33 dhe aneksin E të Deklaratës Ministrore të Hong-Kong-ut (WT/MIN(05)/DEC);

Duke dashur të qartësojnë dhe të përmirësojnë aspektet përkatëse të neneve V, VIII dhe X të GATT 1994, me synimin për të përshpejtuar lëvizjen, kalimin dhe zhdoganimin e mallrave, duke përfshirë mallrat në transit;

Duke njohur nevojat e veçanta të zhvillimit dhe veçanërisht të vendeve anëtare më pak të zhvilluara dhe duke dashur të rrisin ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit në këtë fushë;

Duke njohur nevojën për bashkëpunim efektiv mes anëtarëve mbi lehtësimin e tregtisë dhe çështjet e pajtueshmërisë doganore, kanë rënë dakord si më poshtë:

SEKSIONI I

Neni 1

Publikimi dhe disponueshmëria e informacioneve

1. Publikimi

1.1 Secili anëtar do të publikojë menjëherë informacionet e mëposhtme në një mënyrë jodiskriminuese dhe lehtësisht të aksesueshme me qëllim për të mundësuar qeveritë, tregtarët dhe palët e interesuara për t'u njohur me to:

a) procedurat për importimin, eksportimin dhe kalimin transit (duke përfshirë procedurat e portit, aeroportit dhe pikave të tjera të hyrjes) dhe format dhe dokumentet e kërkuara;

b) normat e aplikuara të detyrimeve dhe taksave të çdo lloji të imponuara ose në lidhje me importimin ose eksportimin;

c) tarifatat dhe pagesat e imponuara nga ose për agjencitë qeveritare ose në lidhje me importimin, eksportimin ose kalimin transit;

d) rregullat për klasifikimin ose vlerësimin e produkteve për qëllime doganore;

e) ligjet, rregulloret dhe vendimet administrative me zbatim të përgjithshëm në lidhje me rregullat e origjinës;

f) kufizimet ose ndalimet e importit, eksportit ose kalimit transit;

g) dispozitat e sanksionit për shkelje të formaliteteve të importit, eksportit ose kalimit transit;

¹ Për qëllime të llogaritjes së pranimeve sipas nenit X.3 të Marrëveshjes së OBT-së, një instrument i pranimit nga Bashkimi Evropian për të dhe në lidhje me vendet anëtare të tij do të llogaritet si praninë nga një numër anëtarësh i barabartë me numrin e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian që janë anëtarë të OBT-së.



h) procedurat për apelim ose shqyrtim;

i) marrëveshjet ose pjesët e saj me çdo shtet ose shtete në lidhje me importimin, eksportimin ose kalimin transit; dhe

j) procedurat në lidhje me administrimin e kuotave tarifore.

1.2 Asgjë në këto dispozita nuk do të interpretohet siç e kërkon publikimi ose dispozita e informacioneve përveç se në gjuhën e anëtarit përveç siç thuhet në paragrafin 2.2.

2. Informacionet e disponueshme përmes internetit

2.1 Çdo anëtar do të vërë në dispozicion dhe përditësojë për aq sa është e mundur dhe e përshtatshme, të mëposhtmet përmes internetit:

a) një përshkrim¹ të procedurave të tij për importimin, eksportimin dhe kalimin transit, duke përfshirë procedurat për apelim ose shqyrtim, që informojnë qeveritë, tregtarët dhe palët e tjera të interesuara mbi hapat praktikë të nevojshëm për importimin, eksportimin dhe transitin;

b) format dhe dokumentet e kërkuara për importimin në eksportimin nga ose transitin përmes territorit të atij anëtar;

c) informacionet e kontaktit mbi pikën/at e tij të kërkimit të informacionit.

2.2 Sipas rastit, përshkrimi i referuar në nënparagrafin 2.1/a do të jetë, gjithashtu, në dispozicion në një prej gjuhëve zyrtare të OBT-së.

2.3 Anëtarët inkurajohen të vënë në dispozicion informacione të mëtejshme të lidhura me tregtinë përmes internetit, duke përfshirë legjislacionin përkatës të lidhur me tregtinë dhe njësi të tjera të referuara në paragrafin 1.1.

3. Pikat e kërkimit të informacionit

3.1 Secili anëtar, brenda burimeve të tij në dispozicion, do të krijojë ose do të mbajë një ose më shumë pika të kërkimit të informacionit për t'iu përgjigjur kërkimit të informacionit nga qeveritë, tregtarët dhe palët e tjera të interesuara mbi çështjet e mbuluara nga paragrafi 1.1 dhe për të ofruar format dhe dokumentet e kërkuara, të referuara në nënparagrafin 1.1/a.

3.2 Anëtarët e një bashkimi doganor ose të përfshirë në integrimin rajonal mund të krijojnë ose mbajnë pika të përbashkëta të kërkimit të informacionit në nivel rajonal për të përmbushur kërkesën e paragrafit 3.1 për procedura të përbashkëta.

3.3 Anëtarët inkurajohen të mos kërkojnë pagimin e një tarife për t'iu përgjigjur kërkimit të informacionit dhe për të ofruar format dhe dokumentet e kërkuara. Nëse ka, anëtarët do të kufizojnë shumën e tarifave dhe pagesave të tyre në koston e përafërt të shërbimeve të dhëna.

3.4 Pikat e kërkimit të informacionit do t'u përgjigjen kërkimeve të informacionit dhe do të ofrojnë format dhe dokumentet brenda një periudhe kohe të arsyeshme të caktuar nga secili anëtar, që mund të variojë në varësi të natyrës ose kompleksitetit të kërkesës.

4. Njoftimi

Çdo anëtar do të njoftojë Komitetin mbi Lehtësimin e Tregtisë të themeluar sipas paragrafit 1.1 të nenit 23 (referuar në këtë Marrëveshje si "Komiteti"), për:

a) vendet zyrtare ku njësitë në nënparagrafët 1.1/"a" në "j" janë publikuar;

b) përcaktuesit uniform të lokacioneve të burimeve të faqes së internetit të referuar në paragrafin 2.1; dhe

c) informacionet e kontaktit të pikave të kërkimit të informacionit të referuara në paragrafin 3.1.

Neni 2

Mundësia për të komentuar informacionet para hyrjes në fuqi dhe konsultimet

1. Mundësia për të komentuar dhe informacionet para hyrjes së fuqi

1.1 Çdo anëtar, në masën e praktikueshme dhe në një mënyrë në përputhje me ligjin dhe sistemin ligjor të tij të brendshëm, ofron mundësi dhe një periudhë kohe të përshtatshme për tregtarët dhe palët e tjera të interesuara për të komentuar mbi hyrjen e propozuar ose ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve me zbatim të përgjithshëm të lidhura me lëvizjen, kalimin dhe zhdoganimin e mallrave, duke përfshirë mallrat në transit.

1.2 Çdo anëtar, në masën e praktikueshme dhe në një mënyrë në përputhje me ligjin dhe sistemin ligjor të tij të brendshëm, do të sigurojë

¹ Çdo anëtar ka liri veprimi për të cituar në faqen e tij të internetit kufizimet ligjore të këtij përshkrimi.



që ligjet dhe rregulloret e reja ose të ndryshuara me zbatim të përgjithshëm të lidhura me lëvizjen, kalimin dhe zhdoganimin e mallrave, duke përfshirë mallrat në transit të publikohen ose përndryshe informacionet mbi to të vihen në dispozicion publikisht, sa më shpejt të jetë e mundur para hyrjes së tyre në fuqi, me qëllim për të mundësuar tregtarët dhe palët e tjera të interesuara që të njihen me to.

1.3 Ndryshimet në normat e pagesës ose normat e tarifës, masat që kanë një efekt lehtësues, masat efikasiteti i të cilave do të pengojë si rezultat i pajtimit me paragrafët 1.1 ose 1.2, masat që aplikohen në rrethana urgjente ose ndryshimet e vogla në ligjin e brendshëm dhe sistemin ligjor përjashtohen secila nga paragrafët 1.1 dhe 1.2.

2. Konsultimet

Çdo anëtar, sipas rastit, do të ofrojë konsultime të rregullta ndërmjet agjencive të tij qeveritare dhe tregtarëve ose palëve të tjera të interesuara që ndodhen brenda territorit të tij.

Neni 3

Vendimet paraprake

1. Çdo anëtar do të nxjerrë një vendim paraprak në një mënyrë të arsyeshme të lidhur me kohën për aplikantin që ka paraqitur një kërkesë me shkrim që përmban të gjitha informacionet e nevojshme. Nëse një anëtar refuzon të nxjerrë një vendim paraprak, ai do të njoftojë menjëherë aplikantin me shkrim, duke përcaktuar faktet përkatëse dhe bazën për vendimin e saj.

2. Një anëtar mund të refuzojë të nxjerrë një vendim paraprak për aplikantin kur pyetja e ngritur në aplikim:

a) është tashmë pezull në rastin e aplikantit para çdo agjencie qeveritare, gjykate apeli ose gjykate; ose

b) është vendosur tashmë nga një gjykatë apeli ose gjykatë.

3. Vendimi paraprak do të jetë i vlefshëm për një periudhë kohe të arsyeshme pas nxjerrjes së tij nëse ligji, faktet ose rrethanat që e mbështesin atë vendim nuk kanë ndryshuar.

4. Kur anëtari revokon, ndryshon ose shfuqizon vendimin paraprak, ai do të sigurojë njoftimin me shkrim të aplikantit, duke përcaktuar faktet përkatëse dhe bazën për

vendimin e tij. Kur një anëtar revokon, ndryshon ose shfuqizon vendimet paraprake me efekt prapaveprues, ai mund ta bëjë këtë vetëm nëse vendimi është bazuar në informacione të paplota, të pasakta, të pavërteta ose mashtruese.

5. Një vendim paraprak i nxjerrë nga një anëtar do të jetë i detyrueshëm mbi atë anëtar në lidhje me aplikantin që e kërkoi atë. Anëtari mund të sigurojë që vendimi paraprak të jetë i detyrueshëm mbi aplikantin.

6. Çdo anëtar do të publikojë, minimalisht:

a) kërkesat për aplikimin për një vendim paraprak, duke përfshirë informacionet që do të ofrohen dhe formatin;

b) periudhën kohore në të cilën ai do të nxjerrë vendimin paraprak; dhe

c) kohëzgjatjen kohore për të cilën vendimi paraprak do të jetë i vlefshëm.

7. Çdo anëtar do të ofrojë, pas kërkesës me shkrim të një aplikanti, një rishikim të vendimit paraprak ose vendimit për të revokuar, ndryshuar ose shfuqizuar vendimin paraprak.²

8. Çdo anëtar do të përpiqet të vërë në dispozicion publikisht çdo informacion mbi vendimet paraprake që ai konsideron se janë me interes të rëndësishëm për palët e tjera të interesuara, duke marrë parasysh nevojën për të mbrojtur informacionet konfidenciale nga ana komerciale.

9. Përkufizimet dhe qëllimi:

a) Një vendim paraprak është një vendim me shkrim që ofrohet nga një anëtar për aplikantin para importimit të një malli të mbuluar nga aplikimi që përcakton trajtimin që anëtari do t'i ofrojë mallit në kohën e importimit në lidhje me:

i) klasifikimin e tarifës së mallit; dhe

ii) origjinën e mallit.³

² Sipas këtij paragrafi: a) një shqyrtim, para ose pasi vendimi të ketë vepruar, mund të sigurohet nga nëpunësi, zyra ose autoriteti që ka nxjerrë vendimin, një autoritet më i lartë ose i pavarur ose një autoritet gjyqësor; dhe b) një anëtari nuk i kërkohet t'i sigurojë aplikantit rekursin për paragrafin 1 të nenit 4.

³ Kuptohet që një vendim paraprak mbi origjinën e mallit mund të jetë një vlerësim i origjinës për qëllime të Marrëveshjes mbi Rregullat e Origjinës ku vendimi përmbush kërkesat e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes mbi Rregullat e Origjinës. Në të njëjtën mënyrë, një vlerësim i origjinës sipas Marrëveshjes mbi Rregullat e Origjinës mund të jetë një vendim paraprak mbi origjinën e një malli për qëllime të kësaj Marrëveshjeje ku vendimi



b) Veç vendimeve paraprake të përcaktuara në nënparagrafin “a”, anëtarët inkurajohen të ofrojnë vendime paraprake mbi:

i) metodën ose kriteret e përshtatshme dhe aplikimin e tyre, për t'u përdorur për përcaktimin e vlerës doganore sipas një grupi të veçantë faktesh;

ii) zbatueshmërinë e kërkesave të anëtarit për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimet doganore;

iii) aplikimin e kërkesave të anëtarit për kuota, duke përfshirë kuotat e tarifës; dhe

iv) çdo çështje shtesë për të cilën një anëtar e konsideron të përshtatshme të nxjerrë një vendim paraprak.

c) Një aplikant është një eksportues, importues ose çdo person me një shkak të justifikueshëm ose një përfaqësues i tyre.

d) Një anëtar mund të kërkojë që aplikanti të ketë përfaqësim ose regjistrim ligjor në territorin e tij. Në masën e mundshme, kërkesa të tilla nuk do të kufizojnë kategoritë e personave që kanë të drejtën të aplikojnë për vendime paraprake, me konsideratë të veçantë për nevojat specifike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto kërkesa do të jenë të qarta dhe transparente dhe nuk do të përbëjnë një mjet të diskriminimit arbitrar ose të pajustificueshëm.

Neni 4

Procedurat për apelim ose shqyrtim

1. Çdo anëtar do të sigurojë që çdo person ndaj të cilit dogana nxjerr një vendim administrativ⁴ të ketë të drejtën, brenda territorit të tij, të një:

përmbush kërkesat e të dyja Marrëveshjeve. Anëtarëve nuk u kërkohet të krijojnë marrëveshje të ndara sipas kësaj dispozite përveç atyre të krijuara në pajtim me Marrëveshjen mbi Rregullat e Originës në lidhje me vlerësimin e originës me kusht që kërkesat e këtij neni të përmbushen.

⁴ Një vendim administrativ në këtë nen nënkupton një vendim me një efekt ligjor që prek të drejtat dhe detyrimet e një personi specifik në një rast individual. Duhet të kuptohet që një vendim administrativ në këtë nen mbulon një veprim administrativ brenda kuptimit të nenit X të GATT 1994 ose dështimi për të marrë një veprim ose vendim administrativ siç parashikohet në ligjin e brendshëm dhe sistemin ligjor të një anëtarit. Për të adresuar një dështim të tillë, anëtarët mund të mbajnë një mekanizëm administrativ alternativ ose rekurs gjyqësor për të drejtuar autoritetin doganor që të nxjerrë menjëherë një vendim administrativ në vend të së drejtës për të apeluar ose shqyrtuar sipas nënparagrafit 1/a.

a) apelimi administrativ ose shqyrtimi nga një autoritet administrativ më i lartë ose i pavarur i nëpunësit ose zyrës që ka nxjerrë vendimin; dhe/ose

b) një apelimi gjyqësor ose shqyrtimi të vendimit.

2. Legjislacioni i një anëtarit mund të kërkojë që një apelim ose shqyrtim administrativ të fillohet para një apelimi ose shqyrtimi gjyqësor.

3. Çdo anëtar do të sigurojë që procedurat e tij për apelim ose shqyrtim të kryhen në një mënyrë jodiskriminuese.

4. Çdo anëtar do të sigurojë që, në rastin kur vendimi mbi apelimin ose shqyrtimin sipas nënparagrafit 1/a nuk jepet:

a) brenda periudhave të caktuara siç specifikohet në ligjet ose rregulloret e tij; ose

b) pa vonesë të papërshtatshme kërkuar ka të drejtën të apelojë më tej ose të shqyrtojë më tej nga autoriteti administrativ ose autoriteti gjyqësor ose çdo rekurs tjetër në autoritetin gjyqësor.⁵

5. Çdo anëtar do të sigurojë që personit të referuar në paragrafin 1 t'i jepen arsyet për vendimin administrativ, në mënyrë që të mundësohet që ky person të ketë të drejtën e rekursit mbi procedurat për apelim ose shqyrtim aty ku është e nevojshme.

6. Çdo anëtar inkurajohet të bëjë të zbatueshme dispozitat e këtij neni në një vendim administrativ të nxjerrë nga një agjenci kufitare përkatëse ndryshe nga doganat.

Neni 5

Masa të tjera për të rritur paanshmërinë, jodiskriminimin dhe transparencën

1. Njoftimet për kontrollet ose inspektimet e shtuara

Kur një anëtar miraton ose mirëmban një sistem të nxjerrjes së njoftimeve ose udhëzimit për autoritetet e saj të interesuara për të rritur nivelin e kontrolleve ose inspektimeve në kufi në lidhje me ushqimin, pijet ose ushqimet për kafshët të mbuluara sipas njoftimit ose udhëzimit për mbrojtjen e jetës ose shëndetit të njeriut,

⁵ Asgjë në këtë paragraf nuk do të ndalojë një anëtar nga njohja e heshtjes administrative mbi apelimin ose shqyrtimin si një vendim në favor të kërkuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tij.



kafshëve ose bimëve brenda territorit të tij, disiplinat e mëposhtme do të zbatohen për mënyrën e lëshimit, përfundimit ose pezullimit të tyre:

a) Anëtari, sipas rastit, mund të nxjerrë njoftimin ose udhëzimin e bazuar mbi rrezikun;

b) Anëtari mund të nxjerrë njoftimin ose udhëzimin në mënyrë që të zbatohet në mënyrë uniforme vetëm në ato pika të hyrjes ku kushtet sanitare dhe fitosanitare mbi të cilat njoftimi ose udhëzimi është bazuar zbatohen;

c) Anëtari do të përfundojë ose do të pezullojë menjëherë njoftimin ose udhëzimin kur rrethanat që e kanë shkaktuar atë nuk ekzistojnë më, ose nëse rrethanat e ndryshuara mund të zgjidhen në një mënyrë më pak kufizuese për tregtinë; dhe

d) Kur anëtari vendos të përfundojë ose të pezullojë njoftimin ose udhëzimin, ai, sipas rastit, do të publikojë menjëherë lajmërimin e përfundimit ose pezullimit të tij në një mënyrë jodiskriminuese dhe lehtësisht të aksesueshme ose të informojë anëtarin eksportues ose importuesin.

2. Ndalimi

Një anëtar do të informojë menjëherë transportuesin ose importuesin në rast të ndalimit të mallrave të deklaruar për importim, për inspektim nga doganat ose çdo autoritet tjetër kompetent.

3. Procedurat e testit

3.1 Një anëtar, sipas kërkesës, mund të japë një mundësi për një test të dytë në rast se rezultatet e testit të parë të një mostre të marrë pas mbërritjes së mallrave të deklaruar për importim tregojnë një gjetje të kundërt.

3.2 Një anëtar do të publikojë, në një mënyrë jodiskriminuese dhe lehtësisht të aksesueshme, emrin dhe adresën e çdo laboratorit ku testi mund të kryhet ose t'ia ofrojë këtë informacion importuesit kur jepet mundësia e parashikuar në paragrafin 3.1.

3.3 Një anëtar do të marrë në konsideratë rezultatit të testit të dytë, nëse ka, të kryer sipas paragrafit 3.1, për kalimin dhe zhdoganimin e mallrave dhe, sipas rastit, mund të pranojë rezultatet e këtij testi.

Neni 6

Disiplinat mbi tarifatat dhe pagesat e imponuara ose në lidhje me importimin dhe eksportimin dhe gjobat

1. Disiplinat e përgjithshme mbi tarifatat dhe pagesat e imponuara ose në lidhje me importimin dhe eksportimin

1.1 Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen për të gjitha tarifatat dhe pagesat të ndryshme nga detyrimet e importit dhe eksportit dhe të ndryshme nga taksat brenda fushëveprimit të nenit III të GATT 1994 të imponuara nga anëtarët mbi ose në lidhje me importimin ose eksportimin e mallrave.

1.2 Informacionet mbi tarifatat dhe pagesat do të publikohen në përputhje me nenin 1. Këto informacione do të përfshijnë tarifatat dhe pagesat që do të zbatohen, arsyen për tarifa dhe pagesa të tilla, autoritetin përgjegjës dhe kur dhe si pagesa do të bëhet.

1.3 Një periudhë kohe e përshtatshme do të jepet ndërmjet publikimit të tarifave dhe pagesave të reja ose të ndryshuara dhe hyrjes së tyre në fuqi, përveç rrethanave urgjente. Këto tarifa dhe pagesa nuk do të zbatohen derisa informacionet për to të jenë publikuar.

1.4 Secili anëtar do të rishikojë periodikisht tarifatat dhe pagesat e tij me synimin për të reduktuar numrin dhe diversitetin e tyre, aty ku është e praktikueshme.

2. Disiplinat specifike mbi tarifatat dhe pagesat për përpunimin doganor të imponuar mbi ose në lidhje me importimin dhe eksportimin

Tarifatat dhe pagesat për përpunimin doganor:

i) do të jenë të kufizuara në sasi në koston e përafërt të shërbimeve të dhëna mbi ose në lidhje me operacionin e importit ose eksportit në fjalë; dhe

ii) nuk kërkohen të lidhen me një operacion specifik importi ose eksporti me kusht që ato të jenë vënë për shërbimet që lidhen ngushtësisht me përpunimin doganor të mallrave.

3. Disiplinat e gjobitjes

3.1 Për qëllim të paragrafit 3, termi “gjoba” do të nënkuptojë ato të imponuara nga një administratë doganore e anëtarit për një shkelje të ligjeve doganore, rregulloreve ose kërkesave procedurale të anëtarit.



3.2 Secili anëtar do të sigurojë që gjobat për një shkelje të ligjit doganor, rregullores ose kërkesës procedurale të imponohen vetëm mbi personin (personat) përgjegjës për shkeljen sipas ligjeve të tij.

3.3 Gjoba e imponuar do të varet nga faktet dhe rrethanat e rastit dhe do të jetë në përpjesëtim me shkallën dhe ashpërsinë e shkeljes.

3.4 Secili anëtar do të sigurojë që ai ruan masat për të shmangur:

a) konfliktet e interesit në vlerësimin dhe mbledhjen e gjobave dhe detyrimeve; dhe

b) krijimin e një stimuli për vlerësimin ose mbledhjen e një gjobe që është e papajtueshme me paragrafin 3.3.

3.5 Secili anëtar do të sigurojë që kur një gjobë të imponohet për shkelje të ligjeve doganore, rregulloreve ose kërkesave procedurale, një shpjegim me shkrim i ofrohet personit (personave) ndaj të cilëve gjoba është imponuar duke specifikuar llojin e shkeljes dhe ligjin, rregulloren ose procedurën e zbatueshme, sipas së cilës shuma ose gama e gjobës për shkeljen është urdhëruar.

3.6 Kur një person i zbulon vullnetarisht administratës doganore të anëtarit rrethanat e një shkeljeje të ligjit doganor, rregullores ose kërkesës procedurale para zbulimit të shkeljes nga administrata doganore, anëtari inkurajohet, sipas rastit, të marrë në konsideratë këtë fakt si një faktor të mundshëm lehtësues kur vendos një gjobë për atë person.

3.7 Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen për gjobat mbi trafikun në transit të referuar në paragrafin 3.1.

Neni 7

Kalimi dhe zhdoganimi i mallrave

1. Përpunimi para mbërritjes

1.1 Secili anëtar do të miratojë ose do të ruajë procedurat që lejojnë dorëzimin e dokumentacionit të importit dhe informacione të tjera të kërkuara, duke përfshirë listat e mallrave, me qëllim për të filluar përpunimin para mbërritjes së mallrave me synimin për të përsheptuar kalimin e mallrave pas mbërritjes.

1.2 Secili anëtar, sipas rastit, do të sigurojë depozitimin paraprak të dokumenteve në format elektronik për përpunim para mbërritjes të këtyre dokumenteve.

2. Pagesa elektronike

Secili anëtar, në masën e praktikueshme, do të miratojë ose ruajë procedurat që lejojnë mundësinë e pagesës elektronike për detyrimet, taksat, tarifat dhe pagesat e mbledhura nga doganat që rezultojnë pas importimit dhe eksportimit.

3. Ndarja e kalimit nga vendosja përfundimtare e detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore

3.1 Secili anëtar do të miratojë ose do të ruajë procedurat që lejojnë kalimin e mallrave para vendosjes së detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore, nëse një vendosje e tillë nuk bëhet para ose pas mbërritjes, ose sa më shpejt të jetë e mundur pas mbërritjes dhe me kusht që të gjitha kërkesat e tjera rregullatore të jenë përmbushur.

3.2 Si një kusht për këtë kalim, një anëtar mund të kërkojë:

a) pagimin e detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore të vendosura para ose pas mbërritjes së mallrave dhe një garanci për çdo shumë ende të pavendosur në formën e një garanti, një depozite ose instrument tjetër të përshtatshëm të parashikuar në ligjet dhe rregulloret e tij; ose

b) një garanci në formën e një garanti, një depozite ose instrument tjetër të përshtatshëm të parashikuar në ligjet dhe rregulloret e tij.

3.3 Një garanci e tillë nuk duhet të jetë më e madhe se shuma që anëtari kërkon për të siguruar pagimin e detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore që në fund të fundit duhen paguar për mallrat e mbuluara nga garancia.

3.4 Në rastet kur një shkelje që kërkon imponimin e dënimeve ose gjobave monetare është zbuluar, një garanci mund të kërkohet për dënimet dhe gjobat që mund të imponohen.

3.5 Garancia siç përcaktohet në paragrafët 3.2 dhe 3.4 do të shkarkohet kur të mos kërkohet më.

3.6 Asgjë në këto dispozita nuk do të prekë të drejtën e një anëtari për të ekzaminuar, ndaluar, poseduar ose konfiskuar ose të merret me mallrat në çdo mënyrë që nuk është e papajtueshme me të drejtat dhe detyrimet e OBT-së së anëtarit.

4. Menaxhimi i rrezikut

4.1 Secili anëtar, për sa është e mundur, do të miratojë ose do të ruajë një sistem të menaxhimit të rrezikut për kontrollin doganor.

4.2 Secili anëtar do të hartojë dhe zbatojë menaxhimin e rrezikut në një mënyrë që të shmangë diskriminimin arbitrar ose të



pajustificueshëm, ose një kufizim të tërthortë mbi tregtinë ndërkombëtare.

4.3 Secili anëtar do të përqendrojë kontrollin doganor dhe, për sa është e mundur kontrollet e tjera kufitare, mbi ngarkesat e mallrave me rrezik të lartë dhe përshejtojnë kalimin e ngarkesave të mallrave me rrezik të ulët. Një anëtar, gjithashtu, mund të zgjedhë, në mënyrë të rastësishme, dërgesat për kontrolle të tilla si pjesë e menaxhimit të tij të rrezikut.

4.4 Secili anëtar do ta bazojë menaxhimin e rrezikut në një vlerësim të rrezikut përmes kriterëve të përshtatshme të përzgjedhshmërisë. Këto kriterë të përzgjedhshmërisë mund të përfshijnë, ndër të tjera, kodin e Sistemit të Harmonizuar, llojin dhe përshkrimin e mallrave, vendin e origjinës, vendin nga i cili mallrat janë dërguar, vlerën e mallrave, procesverbalin e pajtueshmërisë së tregtarëve dhe llojin e mjeteve të transportit.

5. Auditimi pas zhdoganimit

5.1 Me synimin për të përshpejtuar kalimin e mallrave, secili anëtar do të miratojë ose do të ruajë një auditim pas zhdoganimit për të siguruar pajtimin me ligjet dhe rregulloret doganore dhe të tjera të lidhura.

5.2 Secili anëtar do të zgjedhë një person ose një ngarkesë mallrash për auditimin pas zhdoganimit në një mënyrë të bazuar në rrezik, që mund të përfshijë kriteret e përshtatshme të përzgjedhshmërisë. Secili anëtar do të kryejë auditimet pas zhdoganimit në një mënyrë transparente. Kur personi përfshihet në procesin e auditimit dhe rezultatet përfundimtare janë arritur anëtari, pa vonesë, do të njoftojë personin procesverbalin i të cilit është audituar për rezultate, të drejtat dhe detyrimet e personit dhe arsyet për rezultatet.

5.3 Informacionet e marra në auditimin pas zhdoganimit mund të përdoren në procedime të mëtejshme administrative ose gjyqësore.

5.4 Anëtarët, kur është e praktikueshme, do të përdorin rezultatet e auditimit pas zhdoganimit për zbatimin e menaxhimit të rrezikut.

6. Vendosja dhe publikimi i kohës mesatare të kalimit

6.1 Anëtarët inkurajohen për të matur dhe publikuar kohën e tyre mesatare të kalimit të mallrave në mënyrë periodike dhe të pajtueshme, duke përdorur mjete si, mes të tjerash, Studimi i

Kohës së Kalimit i Organizatës Botërore të Doganave (referuar në këtë Marrëveshje si “OBD”).⁶

6.2 Anëtarët inkurajohen të ndajnë me Komitetin eksperiencat e tyre në matjen e kohës mesatare të kalimit, duke përfshirë metodologjitë e përdorura, pengesat e identifikuar, dhe çdo efekt rezultues mbi efikasitetin.

7. Masat e lehtësimit të tregtisë për operatorët e autorizuar

7.1 Secili anëtar do të sigurojë masa shtesë të lehtësimit të tregtisë në lidhje me formalitetet dhe procedurat e importit, eksportit ose kalimit transit, në pajtim me paragrafin 7.3, për operatorët që përmbushin kriteret e specifikuar, në vijim të quajtur operatorët e autorizuar. Në mënyrë alternative, një anëtar mund të ofrojë këto masa të lehtësimit të tregtisë përmes procedurave doganore përgjithësisht në dispozicion për të gjithë operatorët dhe nuk kërkohet të krijohet një skemë e ndarë.

7.2 Kriteret e specifikuar për t'u kualifikuar si një operator i autorizuar do të lidhen me përputhshmërinë ose rrezikun e mospërputhshmërisë, me kërkesat e specifikuar në ligjet, rregulloret ose procedurat e anëtarit.

a) Kriteret e tilla, të cilat do të publikohen, mund të përfshijnë:

i) një procesverbal të përshtatshëm të pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret doganore dhe të tjera të lidhura;

ii) një sistem të menaxhimit të procesverbaleve për të lejuar kontrollet e brendshme të nevojshme;

iii) aftësi pagimi financiare, duke përfshirë, sipas rastit, sigurimin e një sigurie ose garancie të mjaftueshme; dhe

iv) sigurinë e zinxhirit të furnizimit.

b) Kriteret e tilla nuk do të:

i) hartohen ose zbatohen në mënyrë që të japin ose të krijojnë diskriminim arbitrar ose të pajustificueshëm ndërmjet operatorëve ku kushtet e njëjta mbizotërojnë; dhe

ii) në masën e mundshme të kufizojnë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

⁶ Çdo anëtar mund të përcaktojë qëllimin dhe metodologjinë e kësaj matjeje të kohës mesatare të kalimit në përputhje me nevojat dhe kapacitetin e tij.



7.3 Masat e lehtësimit të tregtisë të parashikuara sipas paragrafit 7.1 do të përfshijnë së paku tri nga masat e mëposhtme:⁷

- a) kërkesat e ulëta dokumentare dhe të të dhënave, sipas rastit;
- b) shkallën e ulët të inspektimeve dhe ekzaminimeve fizike, sipas rastit;
- c) kohën e shpejtë të kalimit, sipas rastit;
- d) pagimin e shtyrë të detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave;
- e) përdorimin e garancive gjithëpërfshirëse ose garancive të reduktuara;
- f) një deklaratë të vetme doganore për të gjitha importet ose eksportet në një periudhë të dhënë; dhe
- g) zhdoganimin e mallrave në ambientet e operatorit të autorizuar ose një vend tjetër të autorizuar nga doganat.

7.4 Anëtarët inkurajohen të zhvillojnë skemat e operatorit të autorizuar mbi bazën e standardeve ndërkombëtare, aty ku standarde të tilla ekzistojnë, përveç kur këto standarde do të ishin mjete të papërshtatshme ose joefikase për përmbushjen e objektivave legjitimë të ndjekur.

7.5 Me qëllim për të rritur masat e lehtësimit të tregtisë të ofruara për operatorët, anëtarët do t'i japin anëtarëve të tjerë mundësinë e negociimit të njohjes reciproke të skemave të operatorit të autorizuar.

7.6 Anëtarët do të shkëmbejnë informacionet përkatëse brenda Komitetit rreth skemave në fuqi të operatorit të autorizuar.

8. Dërgesat e përshpejtuara

8.1 Secili anëtar do të miratojë ose ruajë procedurat që lejojnë kalimin e përshpejtuar të së paku atyre mallrave që hyjnë përmes faciliteteve të ngarkesave ajrore për personat të cilët aplikojnë për një trajtim të tillë, ndërsa ruajnë kontrollin doganor.⁸ Nëse një anëtar përdor kufizimin e kriterëve⁹ që mund të zbatohet, anëtarit, në kriteret e publikuara, mund të kërkojë

⁷ Një masë e listuar në nënparagrafët 7.3/a në “g” do të mendohet se ofrohet për operatorët e autorizuar nëse është përgjithësisht në dispozicion për të gjithë operatorët.

⁸ Në rastet kur një anëtar ka një procedurë ekzistuese që siguron trajtimin në paragrafin 8.2, kjo dispozitë nuk kërkon që anëtarit të paraqesë procedura të ndara të kalimit të përshpejtuar.

⁹ Kriteret e tilla të aplikimi, nëse ka, do të jenë përveç kërkesave të anëtarit për operimin në lidhje me mallrat ose dërgesat që hyjnë përmes faciliteteve të ngarkesave ajrore.

që aplikanti, si kushte për kualifikimin për aplikimin e trajtimit të përshkruar në paragrafin 8.2 për dërgesat e tij të përshpejtuara do të:

- a) sigurojë infrastrukturën e përshtatshme dhe pagimin e shpenzimeve doganore në lidhje me përpunimin e dërgesave të përshpejtuara në rastet kur aplikanti përmbush kërkesat e anëtarit që një përpunim i tillë të kryhet në një facilitet të dedikuar;
- b) dorëzojë para mbërritjes së një dërgese të përshpejtuar informacionet e nevojshme për kalimin;

- c) vlerësojë tarifat e kufizuara në shumë në koston e përafërt të shërbimeve të dhëna në ofrimin e trajtimit të përshkruar në paragrafin 8.2;

- d) ruajë një shkallë të lartë të kontrollit mbi dërgesat e përshpejtuara përmes përdorimit të sigurisë së brendshme, logjistikës dhe teknologjisë gjurmuese nga marrja deri te dërgesa;

- e) sigurojë dërgesën e përshpejtuar nga marrja deri te dërgesa;

- f) marrë përsipër përgjegjësinë për pagimin e të gjitha detyrimeve, taksave, tarifave dhe pagesave doganore ndaj autoritetit doganor për mallrat;

- g) ketë një rekord të mirë të pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret doganore dhe të tjera të lidhura;

- h) pajtohet me kushtet e tjera direkt të lidhura me zbatimin efektiv të ligjeve, rregulloreve dhe kërkesave procedural të anëtarit, që lidhen në mënyrë specifike me ofrimin e trajtimit të përshkruar në paragrafin 8.2.

8.2 Duke qenë objekt i paragrafëve 8.1 dhe 8.3, anëtarët do të:

- a) minimizojnë dokumentacionin e kërkuar për kalimin e dërgesave të përshpejtuara në përputhje me paragrafin 1 të nenit 10 dhe, në masën e mundshme, të parashikojë kalimin e bazuar në një paraqitje të vetme të informacioneve mbi dërgesa të caktuara;

- b) sigurojë për dërgesat e përshpejtuara që të kalohen nën rrethana normale sa më shpejt të jetë e mundur pas mbërritjes së tyre, me kusht që informacionet e kërkuara për kalimin të jenë paraqitur;

- c) përpiqet të zbatohet trajtimin në nënparagrafët “a” dhe “b” për dërgesa të çdo peshe



ose vlere duke njohur që një anëtar është i lejuar të kërkojë procedura hyrjeje shtesë, duke përfshirë deklaratat dhe dokumentet mbështetëse dhe pagimin e detyrimeve dhe taksave, dhe për të kufizuar një trajtim të tillë bazuar në llojin e mallit, me kusht që trajtimi të mos kufizohet për mallrat me vlerë të ulët si dokumentet; dhe

d) ofrojë, për sa është e mundur, për një vlerë dërgese *de minimis* ose shumë të tatueshme për të cilën detyrimet doganore dhe taksat nuk do të mblidhen, përveç mallrave të caktuara të parashikuara. Taksat e brendshme, si tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksat e akcizës, të zbatuara për importet në pajtim me nenin III të GATT 1994 nuk janë objekt i kësaj dispozite.

8.3 Asgjë në paragrafët 8.1 dhe 8.2 nuk do të prekë të drejtën e një anëtari për të ekzaminuar, mbajtur, ndalur, konfiskuar ose refuzuar hyrjen e mallrave, ose për të kryer auditimet pas zhdoganimit, duke përfshirë në lidhje me përdorimin e sistemeve të menaxhimit të rrezikut. Më tej, asgjë në paragrafët 8.1 dhe 8.2 nuk do të ndalojë një anëtar për të kaluar, si një kusht për kalimin, paraqitjen e informacioneve shtesë dhe përmbushjen e kërkesave joautomatike të licencimit.

9. Mallrat që prishen¹⁰

9.1 Me synimin për të parandaluar humbjen ose prishjen e shmangshme të mallrave që prishen, dhe me kusht që të gjitha kërkesat rregullatore të jenë përmbushur, secili anëtar do të sigurojë për kalimin e mallrave që prishen:

a) në rrethana normale brenda kohës më të shkurtër të mundshme; dhe

b) në rrethana të jashtëzakonshme kur do të ishte e përshtatshme për ta bërë, jashtë orarit të punës së doganave dhe autoriteteve të tjera përkatëse.

9.2 Secili anëtar do t'i japë prioritetin e duhur mallrave që prishen kur planifikojnë ndonjë ekzaminim që mund të kërkohe.

9.3 Secili anëtar do të bëjë rregullimet ose të lejojë një importues të bëjë rregullimet për ruajtjen e duhur të mallrave që prishen në pritje të kalimit të tyre. Anëtari mund të kërkojë që çdo facilitet ruajtjeje i rregulluar nga importuesi të jetë

miratuar ose caktuar nga autoritetet e tij përkatëse. Lëvizja e mallrave në ato facilitate ruajtjeje, duke përfshirë autorizimet për operatorin që lëviz mallrat, mund të jenë objekt i miratimit, aty ku kërkohet, i autoriteteve përkatëse. Anëtari, aty ku është e praktikueshme dhe në pajtim me legjislacionin e brendshëm, me kërkesë të importuesit, do të sigurojë çdo procedurë të nevojshme që kalimi të bëhet në ato facilitate ruajtjeje.

9.4 Në rastet e vonesës së konsiderueshme në kalimin e mallrave që prishen, dhe pas kërkesës me shkrim, anëtari importues, në masën e praktikueshme, do të sigurojë një komunikim mbi arsyet për vonesën.

Neni 8

Bashkëpunimi i agjencisë kufitare

1. Secili anëtar do të sigurojë që autoritetet dhe agjencitë e tij përgjegjëse për kontrollin dhe procedurat kufitare në lidhje me importimin, eksportimin dhe kalimin transit të mallrave të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe të koordinojnë aktivitetet e tyre me qëllimin për të lehtësuar tregtinë.

2. Secili anëtar, në masën e mundshme dhe të praktikueshme, do të bashkëpunojë mbi kushtet e rëna dakord reciprokisht me anëtarët e tjerë me të cilët ndan një kufi të përbashkët me synimin për të koordinuar procedurat në kalimet kufitare për të lehtësuar tregtinë ndër-kufitare. Një bashkëpunim dhe koordinim i tillë mund të përfshijë:

a) harmonizimin e ditëve dhe orëve të punës;

b) harmonizimin e procedurave dhe formaliteteve;

c) zhvillimin dhe ndarjen e faciliteteve të përbashkëta;

d) kontrollin e përbashkët;

e) krijimin e një postkontrolli kufitar me një ndalim.

Neni 9

Lëvizja e mallrave të destinuara për import nën kontrollin doganor

Secili anëtar, në masën e praktikueshme, dhe me kusht që të gjitha kërkesat rregullatore të jenë përmbushur, do të lejojë që mallrat e destinuara për import të lëvizin brenda territorit të tij nën kontrollin doganor nga një zyrë doganore hyrjeje

¹⁰ Për qëllime të kësaj dispozite, mallrat që prishen janë mallrat që prishen shpejt për shkak të karakteristikave të tyre natyrore, në veçanti në mungesë të kushteve të përshtatshme të ruajtjes.



në një zyrë tjetër doganore në territorin e tij nga ku mallrat do të kalohen ose zhdoganohen.

Neni 10

Formalitetet e lidhura me importimin, eksportimin dhe kalimin transit

1. Formalitetet dhe kërkesat e dokumentacionit

1.1 Me synimin për të minimizuar incidencën dhe kompleksitetin e formaliteteve të importit, eksportit, dhe kalimin transit dhe për të ulur dhe thjeshtuar kërkesat e dokumentacionit të importit, eksportit dhe kalimit transit dhe duke marrë parasysh objektivat legjitime të politikave dhe faktorë të tjerë si rrethanat e ndryshuara, informacionet e reja përkatëse, praktikat e biznesit, disponueshmërinë e teknikave dhe teknologjisë, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe inputet nga palët e interesuara, secili anëtar do të shqyrtojë këto formalitete dhe kërkesa të dokumentacionit dhe bazuar në rezultatet e shqyrtimit, të sigurojë, sipas rastit, që këto formalitete dhe kërkesa dokumentacioni, janë:

a) miratuar dhe/ose zbatuar me synimin e një kalimi dhe zhdoganimi të shpejtë të mallrave, veçanërisht mallrave që prishen;

b) miratuar dhe/ose zbatuar në një mënyrë që synon reduktimin e kohës dhe kostos së pajtimit për tregtarët dhe operatorët;

c) masa më pak kufizuese për tregtinë e zgjedhur kur dy ose më shumë masa alternative janë në mënyrë të arsyeshme në dispozicion për përmbushjen e objektivës ose objektivave të politikave në fjalë; dhe

d) nuk ruhen, duke përfshirë pjesë të tyre, nëse nuk kërkohen më.

1.2 Komiteti do të zhvillojë procedura për ndarjen nga anëtarët të informacioneve dhe praktikave më të mira përkatëse, sipas rastit.

2. Pranimi i kopjeve

2.1 Secili anëtar, sipas rastit, do të përpiqet të pranojë kopjet e letrës ose elektronike të dokumenteve mbështetëse të kërkuara për formalitetet e importit, eksportit ose kalimit transit.

2.2 Kur një agjenci qeveritare e një anëtari tashmë mban originalin e një dokumenti të tillë, çdo agjenci tjetër e atij shteti do të pranojë një kopje letrë ose elektronike, sipas rastit, nga agjencia që mban originalin në vend të dokumentit original.

2.3 Një anëtar nuk do të kërkojë originalin ose kopjen e deklaratave të eksportit që i dorëzohen autoriteteve doganore të anëtarit eksportues si një kërkesë për importim.¹¹

3. Përdorimi i standardeve ndërkombëtare

3.1 Anëtarët inkurajohen të përdorin standardet ndërkombëtare përkatëse ose pjesë të tyre si bazë për formalitetet dhe procedurat e importit, eksportit ose kalimit transit të tyre, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje.

3.2 Anëtarët inkurajohen të marrin pjesë, brenda limiteve të burimeve të tyre, në përgatitjen dhe shqyrtimin periodik të standardeve ndërkombëtare përkatëse nga organizatat ndërkombëtare të përshtatshme.

3.3 Komiteti do të zhvillojë procedura për ndarjen nga anëtarët të informacioneve përkatëse, dhe praktikave më të mira, mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare, sipas rastit.

Komiteti mund të ftojë, gjithashtu, organizatat ndërkombëtare përkatëse që të diskutojnë punën e tyre mbi standardet ndërkombëtare. Sipas rastit, Komiteti mund të identifikojë standardet specifike që janë me një vlerë të veçantë për anëtarët.

4. Dritarja e vetme

4.1 Anëtarët do të përpiqen të krijojnë ose mbajnë një dritare të vetme, për t'i mundësuar tregtarëve që të dorëzojnë dokumentacionin dhe/ose kërkesat e të dhënave për importimin, eksportimin ose kalimin transit të mallrave përmes një pike hyrëse të vetme në autoritetet ose agjencitë pjesëmarrëse. Pas ekzaminimit nga autoritetet ose agjencitë pjesëmarrëse të dokumentacionit dhe/ose të dhënave, rezultatet do t'i njoftohen aplikantëve përmes dritares së vetme në kohën e duhur.

4.2 Në rastet kur dokumentacioni dhe/ose kërkesat e të dhënave janë marrë tashmë përmes dritares së vetme, i njëjti dokumentacion dhe/ose kërkesat e të dhënave nuk do të kërkohen nga autoritetet ose agjencitë pjesëmarrëse përveç se në rrethana urgjente dhe përjashtime të tjera të kufizuara që bëhen publike.

¹¹ Asgjë në këtë paragraf nuk e përjashton një anëtar nga të kërkuarit e dokumenteve, si: certifikata, leje ose licenca si një kërkesë për importimin e mallrave të kontrolluara ose të rregulluara.



4.3 Anëtarët do të njoftojnë Komitetin për detajet e operimit të dritares së vetme.

4.4 Anëtarët, në masën e mundur dhe të praktikueshme, do të përdorin teknologjinë e informacionit për të mbështetur dritaren e vetme.

5. Inspektimi para dërgesës

5.1 Anëtarët nuk do të kërkojnë përdorimin e inspektimeve para dërgesës në lidhje me klasifikimin e tarifës dhe vlerësimin doganor.

5.2 Pa cenuar të drejtat e anëtarëve për të përdorur lloje të tjera të inspektimit para dërgesës që nuk mbulohen nga paragrafi 5.1, anëtarët inkurajohen të mos nxjerrin apo zbatojnë kërkesa të reja në lidhje me përdorimin e tyre.¹²

6. Përdorimi i agjentëve doganorë

6.1 Pa cenuar shqetësimet e rëndësishme të politikës të disa anëtarëve që aktualisht ruajnë një rol të veçantë për agjentët doganorë, nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje anëtarët nuk do të njohin përdorimin e detyrueshëm të agjentëve doganorë.

6.2 Secili anëtar do të njoftojë Komitetin dhe të publikojë masat e tij mbi përdorimin e agjentëve doganorë. Çdo modifikim pasues do të njoftohet dhe publikohet menjëherë.

6.3 Në lidhje me licencimin e agjentëve doganorë, anëtarët do të zbatojnë rregullat që janë transparente dhe objektive.

7. Procedurat e përbashkëta kufitare dhe kërkesat uniforme të dokumentacionit

7.1 Secili anëtar, duke iu nënshtruar paragrafit 7.2, do të zbatojë procedurat e përbashkëta doganore dhe kërkesat uniforme të dokumentacionit për kalimin dhe zhdoganimin e mallrave në të gjithë territorin e tij.

7.2 Asgjë në këtë nen nuk do të ndalojë një anëtar, nga:

a) diferencimi i procedurave dhe kërkesave të dokumentacionit të tij bazuar në natyrën dhe llojin e mallrave, ose mjetet e tyre të transportit;

b) diferencimi i procedurave dhe kërkesave të dokumentacionit të tij për mallrat bazuar në menaxhimin e rrezikut;

c) diferencimi i procedurave dhe kërkesave të dokumentacionit të tij për të siguruar përjashtimin total ose të pjesshëm nga detyrimet ose taksat e

importit;

d) zbatimi i ruajtjes ose përpunimit elektronik; ose

e) diferencimi i procedurave dhe kërkesave të dokumentacionit të tij në një mënyrë të pajtueshme me Marrëveshjen mbi Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare.

8. Mallrat e refuzuara

8.1 Kur mallrat e paraqitura për import refuzohen nga autoriteti kompetent i një anëtari për shkak të dështimit të tyre për të përmbushur rregulloret e parashikuara sanitare dhe fitosanitare ose rregulloret teknike, anëtari, duke iu nënshtruar dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tij, do të lejojë importuesin të ridërgojë ose të kthejë mallrat e refuzuara tek eksportuesi ose një person tjetër i caktuar nga eksportuesi.

8.2 Kur një mundësi e tillë sipas paragrafit 8.1 jepet dhe importuesi dështon së ushtruar atë brenda një periudhe kohe të arsyeshme, autoriteti kompetent mund të marrë një rrjedhë tjetër veprimi për të trajtuar mallra të tilla jo të pajtueshme.

9. Pranimi i përkohshëm i mallrave dhe përpunimi i brendshëm dhe i jashtëm

9.1 Pranimi i përkohshëm i mallrave

Secili anëtar do të lejojë, siç parashikohet në ligjet dhe rregulloret e tij, që mallrat të sillen në territorin e tij të lehtësuar me kusht, totalisht ose pjesërisht, nga pagimi i detyrimeve dhe taksave të importit nëse mallra të tilla sillen në territorin e tij doganor për një qëllim specifik, janë të destinuara për riekспортim brenda një periudhe specifike dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim përveç amortizimit dhe harxhimit normal për shkak të përdorimit që i është bërë atyre.

9.2 Përpunimi i brendshëm dhe i jashtëm

a) Secili anëtar do të lejojë, siç parashikohet në ligjet dhe rregulloret e tij, përpunimin e brendshëm dhe të jashtëm të mallrave. Mallrat e lejuara për përpunimin e jashtëm mund të riimportohen me përjashtim total ose të pjesshëm nga detyrimet dhe taksat e importit në përputhje me ligjet dhe rregulloret e anëtarit.

b) Për qëllimet e këtij neni, termi “përpunim i brendshëm” nënkupton procedurën doganore sipas të cilës mallra të caktuar mund të sillen në territorin doganor të një anëtari të lehtësuar me kusht, totalisht ose pjesërisht, nga pagimi i

¹² Ky paragraf i referohet inspektimeve para dërgesës të mbuluara nga Marrëveshja mbi Inspektimin para dërgesës dhe nuk përjashton inspektimet para dërgesës për qëllime sanitare dhe fitosanitare.



detyrimeve dhe taksave të importit, ose të ligjshëm për rikthimin e pagesës së doganës, mbi bazën që mallra të tilla janë të destinuar për prodhim, përpunim ose riparim dhe eksportim pasues.

c) Për qëllimet e këtij neni, termi “përpunim i jashtëm” nënkupton procedurën doganore sipas të cilës mallrat që janë në qarkullim të lirë në territorin doganor të një anëtarit mund të eksportohen përkohësisht për prodhim, përpunim ose riparim jashtë shteti dhe pastaj të riimportohen.

Neni 11

Liria e kalimit transitit

1. Çdo rregullore ose formalitet në lidhje me trafikun në transit të imponuar nga një anëtar nuk do të:

a) mbahet nëse rrethanat ose objektivat që sjellin miratimin e tyre nuk ekzistojnë më ose nëse rrethanat ose objektivat e ndryshuara mund të trajtohen në një mënyrë më pak kufizuese për tregtinë e disponueshme në mënyrë të arsyeshme;

b) zbatohen në një mënyrë që do të përbënte një kufizim të fshehur mbi trafikun në transit.

2. Trafiku në transit nuk do të kushtëzohet me mbledhjen e çdo tarife ose pagese të imponuar në lidhje me kalimin transit, përveç pagesave për transportin ose ato në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet administrative të shkaktuara nga kalimi transit ose me koston e shërbimeve të dhëna.

3. Anëtarët nuk do të kërkojnë, marrin ose mbajnë çdo kufizim vullnetar ose masa të tjera të ngjashme mbi trafikun në transit. Kjo nuk duhet të cenojë rregulloret kombëtare ekzistuese dhe të ardhshme, marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të lidhura me rregullimin e transportit, në pajtim me rregullat e OBT-së.

4. Secili anëtar do t'i akordojë produkteve që do të jenë në transit përmes territorit të çdo anëtarit tjetër trajtim më pak të favorshëm nga ai që do t'u jepej produkteve të tilla nëse ato do të transportoheshin nga vendi i tyre i origjinës në destinacionin e tyre pa kaluar në territorin e këtij anëtarit tjetër.

5. Anëtarët inkurajohen të vënë në dispozicion, sipas rastit, infrastrukturën e ndarë fizikisht (si korsitë, vendet e bankinës dhe të

ngjashme) për trafikun në transit.

6. Formalitetet, kërkesat e dokumentacionit dhe kontrollet doganore në lidhje me trafikun në transit nuk do të jenë më të rënda nga sa është e nevojshme, për të:

a) identifikuar mallrat; dhe

b) siguruar përmbushjen e kërkesave të kalimit transit.

7. Pasi mallrat janë vendosur nën një procedurë transiti dhe janë autorizuar për të vazhduar nga pika e origjinës në territorin e anëtarit, ata nuk do t'i nënshtrohen pagesave doganore dhe as vonesave ose kufizimeve të panevojshme deri sa ata të përfundojnë kalimin transit të tyre në pikën e destinacionit brenda territorit të anëtarit.

8. Anëtarët nuk do të zbatojnë rregulloret teknike dhe procedurat e vlerësimit të pajtueshmërisë brenda kuptimit të Marrëveshjes mbi Barrierat Teknike të Tregtisë të mallrave në transit.

9. Anëtarët do të lejojnë dhe sigurojnë paraqitjen dhe përpunimin paraprak të dokumentacionit dhe të dhënave të kalimit transit para mbërritjes së mallrave.

10. Sapo trafiku në transit të arrijë zyrën doganore ku ka daljen nga territori i një anëtarit, ajo zyrë do të përfundojë menjëherë operacionin e kalimit transit nëse kërkesat e kalimit transit janë përmbushur.

11. Kur një anëtar kërkon një garanci në formën e një garanti, depozite ose instrumenti tjetër monetar ose jomonetar¹³ të përshtatshëm për trafikun në transit, një garanci e tillë do të kufizohet për të siguruar që kërkesat që lindin nga një trafik i tillë në transit janë përmbushur.

12. Sapo anëtarit ka vendosur që kërkesat e tij të kalimit transit janë përmbushur, garancia do të shkarkohet pa vonesë.

13. Secili anëtar, në një mënyrë të pajtueshme me ligjet dhe rregulloret e tij, do të lejojë garancinë gjithëpërfshirëse që përfshin transaksione të shumfishta për të njëjtët operatorë ose rinovim të garancive pa shkarkim për dërgesat pasuese.

14. Secili anëtar do të vërë në dispozicion publikisht informacionet përkatëse që ai përdor

¹³Asgjë në këtë dispozitë nuk do të përjashtojë një anëtar nga mbajtja e procedurave ekzistuese përmes të cilave mjetet e transportit mund të përdoren si një garanci për trafikun në transit.



për të vënë garancinë, duke përfshirë transaksionin e vetëm dhe, sipas rastit, garancinë e transaksionit të shumëfishtë.

15. Secili anëtar mund të kërkojë përdorimin e shoqërimit doganor ose eskortës doganore për trafikun në transit vetëm në rrethanat që paraqesin rreziqe të larta ose kur pajtimi me ligjet dhe rregulloret doganore nuk mund të sigurohet përmes përdorimit të garancive. Rregullat e përgjithshme që zbatohen për shoqërimet doganore ose eskortat doganore do të publikohen në përputhje me nenin 1.

16. Anëtarët do të përpiqen të bashkëpunojnë dhe koordinojnë me njëri-tjetrin me synimin për të rritur lirinë e kalimit transit. Një bashkëpunim dhe koordinim i tillë mund të përfshijë, por pa kufizim, një mirëkuptim mbi:

- a) pagesat;
- b) formalitetet dhe kërkesat ligjore; dhe
- c) operimin praktik të regjimeve të kalimit transit.

17. Secili anëtar do të përpiqet të caktojë një koordinator kombëtar të kalimit transit të cilit mund t'i drejtohen të gjitha pyetjet dhe propozimet nga anëtarët e tjerë në lidhje me funksionimin e tyre të operacioneve të kalimit transit.

Neni 12

Bashkëpunimi doganor

1. Masat që nxisin pajtimin dhe bashkëpunimin

1.1 Anëtarët bien dakord mbi rëndësinë e sigurimit që tregtarët janë të vetëdijshëm mbi detyrimet e tyre të pajtueshmërisë, duke nxitur pajtimin vullnetar për të lejuar importuesit që të vetëkorrigjohen pa gjobitje në rrethanat e përshtatshme dhe për të zbatuar masat e pajtimit për të filluar masat më të forta për tregtarët që nuk pajtohen.¹⁴

1.2 Anëtarët inkurajohen të ndajnë informacionet mbi praktikat më të mira në menaxhimin e pajtimit doganor, duke përfshirë përmes Komitetit. Anëtarët inkurajohen të bashkëpunojnë në udhëzimin ose ndihmën

teknike dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit për qëllime të administrimit të masave të pajtimit dhe rritjes së efikasitetit të tyre.

2. Shkëmbimi i informacionit

2.1 Me kërkesë dhe duke iu nënshtruar dispozitave të këtij neni, anëtarët do të shkëmbejnë informacionin e përcaktuar në nënparagrafët 6.1/“b” dhe/ose “c” me qëllim verifikimin e një deklarate importi ose eksporti në rastet e identifikuar ku ka baza të arsyeshme për të dyshuar të vërtetën ose saktësinë e deklaratës.

2.2 Secili anëtar do të njoftojë Komitetin mbi detajet e pikës së tij të kontaktit për shkëmbimin e këtij informacioni.

3. Verifikimi

Një anëtar do të bëjë një kërkesë për informacion vetëm pasi të ketë kryer procedurat e përshtatshme të verifikimit të një deklarate importi ose eksporti dhe pasi të ketë inspektuar dokumentacionin përkatës në dispozicion.

4. Kërkesa

4.1 Anëtari kërkues do të sigurojë anëtarin e kërkuar me një kërkesë me shkrim, përmes mjeteve në letër ose elektronike në një gjuhë zyrtare të OBT-së të rënë dakord reciprokisht ose një gjuhë tjetër e rënë dakord reciprokisht, duke përfshirë:

a) çështjen në fjalë duke përfshirë, ku është e përshtatshme dhe e disponueshme, numrin identifikues të deklaratës së eksportit që i korrespondon deklaratës së importit në fjalë;

b) qëllimin për të cilin anëtari kërkues po kërkon informacionin ose dokumentet, së bashku me emrat dhe detajet e kontaktit të personave me të cilët kërkesa lidhet, nëse njihen;

c) aty ku kërkohet nga anëtari i kërkuar, konfirmimi¹⁵ i verifikimit sipas rastit;

d) informacionet ose dokumentet specifike të kërkuar;

e) identitetin e zyrës origjinuese që bën kërkesën;

f) referimin në dispozitat e ligjit të brendshëm të anëtarit kërkues dhe sistemit ligjor që rregullon mbledhjen, mbrojtjen, përdorimin, zbulimin, mbajtjen dhe hedhjen e informacioneve konfidenciale dhe të dhënave personale.

¹⁴ Një aktivitet i tillë ka objektivin e përgjithshëm për të ulur frekuencën e mospajtimit dhe si pasojë reduktimin e nevojës për shkëmbim të informacioneve në ndjekje të zbatimit.

¹⁵ Kjo mund të përfshijë informacionet përkatëse mbi verifikimin e kryer sipas paragrafit 3. Informacione të tilla do të jenë objekt i nivelit të mbrojtjes dhe të specifikuar në mënyrë konfidenciale nga anëtari që kryen verifikimin.



4.2 Nëse anëtari kërkues nuk është në pozicionin për t'u pajtuar me secilin nga nënparagrafët e paragrafit 4.1, ai duhet ta specifikojë këtë në kërkesë.

5. Mbrojtja dhe konfidencialiteti

5.1 Anëtari kërkues, duke iu nënshtruar paragrafit 5.2, do të:

a) mbajë të gjithë informacionet ose dokumentet e siguruar nga anëtari i kërkuar konfidenciale në mënyrë strikte dhe të japë së paku të njëjtin nivel mbrojtjeje dhe konfidencialiteti të tillë si ai i ofruar sipas ligjit të brendshëm dhe sistemit ligjor të anëtarit të kërkuar, siç përshkruhet nga ai sipas nënparagrafëve 6.1/“b” ose “c”;

b) ofrojë informacionet ose dokumentet vetëm për autoritetet doganore që merren me çështjen në fjalë dhe përdorë informacionet ose dokumentet vetëm për qëllimin e përcaktuar në kërkesë përveç nëse anëtari i kërkuar bie dakord ndryshe me shkrim;

c) mos zbulojë informacionet ose dokumentet pa lejen specifike me shkrim të anëtarit të kërkuar;

d) mos përdorë informacionet ose dokumentet e paverifikuara nga anëtari i kërkuar si faktor vendosës drejt lehtësisimit të dyshimit në çdo rrethanë të dhënë;

e) respektojë çdo kusht të rastit specifik të përcaktuar nga anëtari i kërkuar në lidhje me mbajtjen dhe hedhjen e informacioneve ose dokumenteve konfidenciale dhe të dhënave personale; dhe

f) sipas kërkesës, të informojë anëtarin e kërkuar për çdo vendim dhe veprim të marrë mbi çështjen si rezultat i informacioneve ose dokumenteve të ofruara.

5.2 Një anëtar kërkues mund të mos jetë në gjendje sipas ligjit të brendshëm dhe sistemit ligjor të tij të pajtohet me secilin prej nënparagrafëve të paragrafit 5.1. Nëse ndodh kështu, anëtari kërkues do ta specifikojë këtë në kërkesë.

5.3 Anëtari i kërkuar do të trajtojë çdo kërkesë dhe informacion verifikimi të marrë sipas paragrafit 4 me së paku të njëjtin nivel të mbrojtjes dhe konfidencialitetit të dhënë nga anëtari i kërkuar për informacionet e tij të ngjashme.

6. Ofrimi i informacioneve

6.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të këtij neni, anëtari i kërkuar menjëherë do të:

a) përgjigjet me shkrim, përmes letrës ose mjeteve elektronike;

b) ofrojë informacionet specifike, siç përcaktohen në deklaratën e importit ose eksportit, ose deklaratës, në masën që është e disponueshme, së bashku me një përshkrim të nivelit të mbrojtjes dhe konfidencialitetit të kërkuar të anëtarit kërkues;

c) nëse kërkohet, ofron informacionet specifike siç përcaktohet në dokumentet e mëposhtme ose dokumentet, e paraqitura në mbështetje të deklaratës së importit ose eksportit, në masën që është e disponueshme: faturën tregtare, listën e paketimit, certifikatën e origjinës dhe faturën e ngarkesës, në formën në të cilën ato janë depozituar, përmes letrës ose elektronike, së bashku me një përshkrim të nivelit të mbrojtjes dhe konfidencialitetit të kërkuar të anëtarit kërkues;

d) konfirmojë që dokumentet e ofruara janë kopje të vërteta;

e) ofrojë informacionet ose përndryshe t'i përgjigjet kërkesës, në masën e mundshme, brenda 90 ditëve nga data e kërkesës.

6.2 Anëtari i kërkuar mund të kërkojë, sipas ligjit të brendshëm dhe sistemit ligjor të tij, një sigurim para ofrimit të informacioneve që informacionet specifike nuk do të përdoren si provë në hetime penale, procedime gjyqësore ose procedime jodoganore pa miratimin specifik me shkrim të anëtarit të kërkuar. Nëse anëtari kërkues nuk është në pozicionin për t'u pajtuar me këtë kërkesë, ai duhet t'ia specifikojë këtë anëtarit të kërkuar.

7. Shtyrja ose refuzimi i një kërkesë

7.1 Një anëtar i kërkuar mund të shtyjë ose refuzojë një pjesë ose të gjithë kërkesën për të ofruar informacione, dhe do të informojë anëtarin kërkues për arsyet për të bërë kështu, aty ku:

a) do të ishte në kundërshtim me interesin publik siç reflektohet në ligjin e brendshëm dhe sistemit ligjor të anëtarit të kërkuar;

b) ligji i brendshëm dhe sistemi ligjor i tij e ndalon dhënien e informacioneve. Në një rast të tillë ai do t'i ofrojë anëtarit kërkues një kopje të referencës përkatëse, specifike;



c) ofrimi i informacioneve do të pengonte zbatimin e ligjit ose përndryshe do të binte ndesh me një hetim, ndjekje ose procedim administrativ ose gjyqësor në vazhdim;

d) miratimi i importuesit ose eksportuesit kërkohet nga ligji i brendshëm ose sistemi ligjor i tij që rregullon mbledhjen, mbrojtjen, përdorimin, zbulimin, mbajtjen dhe hedhjen e informacioneve konfidenciale ose të dhënave personale dhe ai miratim nuk jepet; ose

e) kërkesa për informacione merret pas skadimit të kërkesës ligjore të anëtarit të kërkuar për mbajtjen e dokumenteve.

7.2 Në rrethanat e paragrafëve 4.2, 5.2 ose 6.2, ekzekutimi i një kërkesë të tillë do të jetë në diskrecionin e anëtarit të kërkuar.

8. Reciprociteti

Nëse anëtari kërkues është i mendimit që ai nuk do të ishte në gjendje të pajtohej me një kërkesë të ngjashme nëse ajo do të bëhej nga anëtari i kërkuar, ose nëse ai nuk ka zbatuar ende këtë nen, ai do ta konstatojë atë fakt në kërkesën e tij. Ekzekutimi i një kërkesë të tillë do të jetë në diskrecionin e anëtarit të kërkuar.

9. Barra administrative

9.1 Anëtari kërkues do të marrë parasysh burimin e lidhur dhe implikimet e kostos për anëtarin e kërkuar në përgjigje të kërkesave për informacione. Anëtari kërkues do të marrë në konsideratë proporcionalitetin ndërmjet interesit të tij fiskal në ndjekjen e kërkesës së tij dhe përpjekjet që do të bëhen nga anëtari i kërkuar në ofrimin e informacioneve.

9.2 Nëse një anëtar i kërkuar merr një numër të pakontrollueshëm kërkesash për informacione ose një kërkesë për informacione me shtrirje të pakontrollueshme nga një ose më shumë anëtar kërkues dhe nuk është në gjendje të përmbushë kërkesa të tilla brenda një kohe të arsyeshme, ai mund t'i kërkojë një ose më shumë anëtarëve kërkues që të përcaktojnë përparësitë me synimin për të rënë dakord mbi një limit praktik brenda kufizimeve të burimeve të tij. Në mungesë të një qasjeje të rënë dakord reciprokisht, ekzekutimi i këtyre kërkesave do të jetë në diskrecionin e anëtarit të kërkuar bazuar në rezultatet e përcaktimit të tij të prioriteteve.

10. Kufizimet

a) Një anëtari të kërkuar nuk do t'i kërkohet të:

b) modifikojë formatin e deklaratave ose procedurave të tij të importit ose eksportit;

kërkojë dokumente përveç atyre të paraqitura me deklaratën e importit ose eksportit siç specifikohet në nënparagrafin 6.1/c;

c) fillojë hetimet për të marrë informacionet;

d) modifikojë periudhën e mbajtjes së informacioneve të tilla;

e) të paraqesë dokumentacion në letër aty ku formati elektronik është paraqitur tashmë;

f) përkthejë informacionet;

g) verifikojë saktësinë e informacioneve; ose

h) ofrojë informacione që do të binin ndesh me interesat e ligjshme tregtare të ndërmarrjeve të veçanta, publike ose private.

11. Përdorimi ose zbulimi i paautorizuar

11.1 Në rast të shkeljes së kushteve të përdorimit ose të zbulimit të informacione të shkëmbyera sipas këtij neni, anëtari kërkues që ka marrë informacionet do të komunikojë menjëherë detajet e një përdorimi ose zbulimi të tillë të paautorizuar për anëtarin e kërkuar që ka ofruar informacionet; dhe:

a) do të marrë masat e nevojshme për të ndrequr shkeljen;

b) do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar shkeljet e ardhshme; dhe

c) do të njoftojë anëtarin e kërkuar mbi masat e marra sipas nënparagrafëve “a” dhe “b”.

11.2 Anëtari i kërkuar mund të pezullojë detyrimet e tij ndaj anëtarit kërkues sipas këtij neni deri sa masat e përcaktuara në paragrafin 11.1 të jenë marrë.

12. Marrëveshjet bilaterale dhe rajonale

12.1 Asgjë në këtë nen nuk do të ndalojë një anëtar nga hyrja ose mbajtja e një marrëveshjeje bilaterale, plurilaterale ose rajonale për ndarjen ose shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave doganore, duke përfshirë mbi një bazë të sigurt dhe të shpejtë si mbi bazë automatike ose përpara mbërritjes së dërgesës.

12.2 Asgjë në këtë nen nuk do të interpretohet sikur ndryshon ose prek të drejtat ose detyrimet e anëtarit sipas marrëveshjeve të tilla bilaterale, plurilaterale ose rajonale ose sikur rregullon shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave doganore sipas marrëveshjeve të tjera të tilla.



SEKSIONI II
DISPOZITAT E TRAJTIMIT TË VEÇANTË
DHE TË DIFERENCUAR PËR VENDET
ANËTARE NË ZHVILLIM DHE VENDET
ANËTARE MË PAK TË ZHVILLUARA

Neni 13

Parime të përgjithshme

1. Dispozitat e përfshira në nenin 1 deri në 12 të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen nga vendet anëtare në zhvillim dhe më pak të zhvilluara në përputhje me këtë seksion, që bazohet në modalitetet e rëna dakord në aneksin D të Marrëveshjes Komizë, korrik 2004 (WT/L/579) dhe në paragrafin 33 të aneksit E të Deklaratës Ministrore të Hong-Kongut (WT/MIN(05)/DEC).

2. Ndihmë dhe mbështetje për ndërtimin e kapacitetit¹⁶ do të ofrohet për të ndihmuar vendet anëtare në zhvillim dhe më pak të zhvilluara të zbatojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me natyrën dhe qëllimin e tyre. Shtrirja dhe koha e zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të lidhet me kapacitetet e zbatimit të vendeve anëtare në zhvillim dhe më pak të zhvilluara. Kur një vend anëtar në zhvillim ose më pak i zhvilluar vazhdon të ketë mungesë të kapacitetit të nevojshëm, zbatimi i dispozitave në fjalë nuk do të kërkohet derisa kapaciteti i zbatimit të jetë fituar.

3. Vendeve anëtare më pak të zhvilluara do t'u kërkohet vetëm të marrin përsipër angazhimet në masën e pajtueshme me zhvillimin e tyre individual, nevojat financiare dhe tregtare ose aftësitë e tyre administrative dhe institucionale.

4. Këto parime do të zbatohen përmes dispozitave të përcaktuara në seksionin II.

Neni 14

Kategoritë e dispozitave

1. Ekzistojnë tri kategori të dispozitave:

a) Kategoria A përmban dispozita që një vend anëtar në zhvillim ose një vend anëtar më pak i zhvilluar cakton për zbatim pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ose në rastin e një vendi anëtar

më pak të zhvilluar brenda një viti pas hyrjes në fuqi, siç parashikohet në nenin 15.

b) Kategoria B përmban dispozita që një vend anëtar në zhvillim ose një vend anëtar më pak i zhvilluar cakton për zbatim në një datë pas një periudhe kalimtare kohe pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, siç parashikohet në nenin 16.

c) Kategoria C përmban dispozita që një vend anëtar në zhvillim ose një vend anëtar më pak i zhvilluar cakton për zbatim në një datë pas një periudhe kalimtare kohe pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe kërkon fitimin e kapacitetit të zbatimit përmes ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit, siç parashikohet në nenin 16.

2. Çdo vend anëtar në zhvillim dhe më pak i zhvilluar do të vetëcaktojë, mbi baza individuale, dispozitat ku ai do të përfshihet sipas secilës prej kategorive A, B dhe C.

Neni 15

Njoftimi dhe zbatimi i kategorisë A

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo vend anëtar në zhvillim do të zbatojë angazhimet e tij të kategorisë A. Ato angazhime të caktuara sipas kategorisë A do të jenë në këtë mënyrë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

2. Një vend anëtar më pak i zhvilluar mund të njoftojë Komitetin mbi dispozitat që ai ka caktuar në kategorinë A për deri në një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Çdo angazhim i vendit anëtar më pak të zhvilluar i caktuar sipas kategorisë A do të jetë në këtë mënyrë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Njoftimi i datave përfundimtare për zbatimin e kategorisë B dhe kategorisë C

1. Në lidhje me dispozitat që një vend anëtar në zhvillim nuk ka përcaktuar në kategorinë A, vendi anëtar mund të vonojë zbatimin në përputhje me procesin e përcaktuar në këtë nen.

Vendi anëtar në zhvillim kategoria B

a) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, secili vend anëtar në zhvillim do të njoftojë Komitetin për dispozitat që ka përcaktuar në kategorinë B dhe datat e tyre korresponduese

¹⁶ Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, “ndihma dhe mbështetja për ndërtimin e kapacitetit” mund të marrë formën e ndihmës teknike, financiare ose çdo formë tjetër ndihme të ofruar të rënë dakord reciprokisht.



treguese për zbatimin.¹⁷

b) Jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, secili vend anëtar në zhvillim do të njoftojë Komitetin për datat e tij përfundimtare për zbatimin e dispozitave që ai ka përcaktuar në kategorinë B. Nëse një vend anëtar në zhvillim, para këtij afati, beson se ai kërkon kohë shtesë për të njoftuar datat e tij përfundimtare, anëtari mund të kërkojë që Komiteti të zgjasë periudhën e mjaftueshme për të njoftuar datat e tij.

Vendi anëtar në zhvillim kategoria C

c) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, secili vend anëtar në zhvillim do të njoftojë Komitetin për dispozitat që ka përcaktuar në kategorinë C dhe datat e tyre korresponduese treguese për zbatimin. Për qëllime transparence, njoftimet e dorëzuara do të përfshijnë informacionet mbi ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit që anëtari kërkon me qëllim që t'i zbatojë.¹⁸

d) Brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, vendet anëtare në zhvillim dhe anëtarët donator përkatës, duke marrë parasysh çdo marrëveshje ekzistuese tashmë në fuqi, njoftimet në pajtim me paragrafin 1 të nenit 22 dhe informacionet e paraqitura në pajtim me nënparagrafin “c” më sipër, do të ofrojnë informacione për Komitetin mbi marrëveshjet e ruajtura ose që kanë hyrë që janë të nevojshme për të ofruar ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit për të mundësuar zbatimin e kategorisë C.¹⁹ vendi anëtar pjesëmarrës në zhvillim do të informojë menjëherë Komitetin për marrëveshje të tilla. Komiteti do të ftojë, gjithashtu, donatorët joanëtar për të ofruar informacione mbi

marrëveshjet ekzistuese ose të konkluduara.

e) Brenda 18 muajve nga data e ofrimit të informacioneve të përcaktuara në nënparagrafin “d”, anëtarët donator dhe anëtarët respektiv në zhvillim do të informojnë Komitetin mbi progresin në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit. Çdo vend anëtar në zhvillim, në të njëjtën kohë, do të njoftojë listën e tij të datave përfundimtare për zbatimin.

2. Në lidhje me ato dispozita që një vend anëtar më pak i zhvilluar nuk ka përcaktuar sipas kategorisë A, vendet anëtare më pak të zhvilluara mund të vonojnë zbatimin në përputhje me procesin e përcaktuar në këtë nen.

Vendi anëtar më pak i zhvilluar kategoria B

a) Jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një vend anëtar më pak i zhvilluar do të njoftojë Komitetin për dispozitat e tij të kategorisë B dhe mund të njoftojë datat e tyre korresponduese treguese për zbatimin e këtyre dispozitave, duke marrë parasysh fleksibilitetet maksimale për vendet anëtare më pak të zhvilluara.

b) Jo më vonë se dy vjet pas datës së njoftimit të përcaktuar në nënparagrafin “a” më sipër, secili vend anëtar më pak i zhvilluar do të njoftojë Komitetin për të konfirmuar caktimet e dispozitave dhe të njoftojë datat e tij për zbatimin. Nëse një vend anëtar më pak i zhvilluar, para këtij afati, beson që ai kërkon kohë shtesë për të njoftuar datat e tij përfundimtare, anëtari mund të kërkojë që Komiteti të zgjasë periudhën e mjaftueshme për të njoftuar datat e tij.

Vendi anëtar në zhvillim kategoria C

c) Për qëllime transparence dhe për të lehtësuar marrëveshjet me donatorët, një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, secili vend anëtar më pak i zhvilluar do të njoftojë Komitetin për dispozitat që ka përcaktuar në kategorinë C duke marrë parasysh fleksibilitetet maksimale për vendet anëtare më pak të zhvilluara.

d) Një vit pas datës së përcaktuar në nënparagrafin “c” më sipër, vendet anëtare më pak të zhvilluara do të njoftojnë informacionet mbi ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit që anëtari kërkon me qëllim që t'i

¹⁷ Njoftimet e paraqitura mund të përfshijnë, gjithashtu, informacione të tilla të mëtejshme siç anëtari njoftues i mendon të përshtatshme. Anëtarët inkurajohen të ofrojnë informacione mbi agjencinë ose entitetin e brendshëm përgjegjës për zbatimin.

¹⁸ Anëtarët mund të përfshijnë, gjithashtu, informacione mbi planet ose projektet kombëtare të zbatimit të lehtësimit të tregtisë, agjencinë ose entitetin e brendshëm përgjegjës për zbatimin dhe donatorët me të cilët anëtari mund të ketë një marrëveshje për të ofruar ndihmën.

¹⁹ Marrëveshje të tilla do të jenë mbi kushtet e rena dakord reciprokisht, në formë bilateral ose përmes organizatave të përshtatshme ndërkombëtare, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 21.



zbatojë.²⁰

e) Jo më vonë se dy vjet pas njoftimit sipas nënparagrafit “d” më sipër, vendet anëtare më pak të zhvilluara dhe anëtarët donatorë përkatës, duke marrë parasysh informacionet e paraqitura në pajtim me nënparagrafin “d” më sipër, do të ofrojnë informacione për Komitetin mbi marrëveshjet e ruajtura ose që kanë hyrë që janë të nevojshme për të ofruar ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit për të mundësuar zbatimin e kategorisë C.²¹ vendi anëtar pjesëmarrës më pak i zhvilluar do të informojë menjëherë Komitetin për marrëveshje të tilla. Vendi anëtar më pak i zhvilluar, në të njëjtën kohë, do të njoftojë datat treguese për zbatimin e angazhimeve korresponduese të kategorisë C të mbuluara nga marrëveshjet e ndihmës dhe mbështetjes. Komiteti do të ftojë, gjithashtu, donatorët joanëtar për të ofruar informacione mbi marrëveshjet ekzistuese ose të konkluduara.

f) Jo më vonë se 18 muaj nga data e ofrimit të informacioneve të përcaktuara në nënparagrafin “e”, anëtarët donatorë përkatës dhe vendet anëtare respektive më pak të zhvilluara do të informojnë Komitetin mbi progresin në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit. Çdo vend anëtar më pak i zhvilluar, në të njëjtën kohë, do të njoftojë listën e tij të datave përfundimtare për zbatimin.

3. Vendet anëtare në zhvillim dhe vendet anëtare më pak të zhvilluara që hasin vështirësi në dorëzimin e datave përfundimtare për zbatimin brenda afateve të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2, për shkak të mungesës së mbështetjes së donatorit ose mungesës së progresit në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit duhet të njoftojnë Komitetin sa më shpejt që jetë e mundur para mbarimit të atyre afateve. Anëtarët bien dakord të bashkëpunojnë për të asistuar në zgjidhjen e

²⁰ Anëtarët mund të përfshijnë, gjithashtu, informacione mbi planet ose projektet kombëtare të zbatimit të lehtësimit të tregtisë, agjencinë ose entitetin e brendshëm përgjegjës për zbatimin dhe donatorët me të cilët anëtari mund të ketë një marrëveshje për të ofruar ndihmën.

²¹ Marrëveshje të tilla do të jenë mbi kushtet e rëna dakord reciprokisht, në formë bilateral ose përmes organizatave të përshtatshme ndërkombëtare, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 21.

vështirësive të tilla, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta dhe problemet e veçanta që has anëtari në fjalë. Komiteti, sipas rastit, do të marrë masa për të zgjidhur vështirësitë duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, zgjatjen e afateve për anëtarin në fjalë për të njoftuar datat e tij përfundimtare.

4. Tre muaj para afatit të përcaktuar në nënparagrafët 1/“b” ose “e”, ose në rastin e vendit anëtar më pak të zhvilluar, nënparagrafët 2/“b” ose “f”, Sekretariati do t’i kujtojë një anëtar nëse ai anëtar nuk ka njoftuar ende një datë përfundimtare për zbatimin e dispozitave që ai ka përcaktuar në kategorinë B ose C. Nëse anëtari nuk i referohet paragrafit 3, ose në rastin e një vendi anëtar në zhvillim nënparagrafit 1/b, ose në rastin e një vendi anëtar më pak të zhvilluar nënparagrafit 2/“b”, për të zgjatur afatin dhe ende nuk njofton një datë përfundimtare për zbatimin, anëtari do të zbatojë dispozitat brenda një viti pas afatit të përcaktuar në nënparagrafët 1/“b” ose “e”, ose në rastin e një vendi anëtar më pak të zhvilluar, nënparagrafët 2/“b” ose “f”, ose të zgjatur nga paragrafi 3.

5. Jo më vonë se 60 ditë pas datave për njoftimin e datave përfundimtare për zbatimin e dispozitave të kategorisë B dhe kategorisë C, në përputhje me paragrafët 1, 2 ose 3, Komiteti do të marrë shënim anekset që përfshijnë datat përfundimtare të secilit anëtar për zbatimin e dispozitave të kategorisë B dhe kategorisë C, duke përfshirë çdo datë të përcaktuar sipas paragrafit 4, duke i bërë në këtë mënyrë këto anekse një pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Mekanizmi i paralajmërimit të hershëm: zgjatja e datave të zbatimit për dispozitat në kategoritë B dhe C

1.

a) Një vend anëtar në zhvillim ose vend anëtar më pak i zhvilluar që e konsideron veten se po kalon vështirësi në zbatimin e një dispozite që ai ka përcaktuar në kategorinë B ose kategorinë C, në datën përfundimtare të vendosur sipas nënparagrafëve 1/“b” ose “e” të nenit 16, ose në rastin e vendit anëtar më pak të zhvilluar nënparagrafët 2/“b” ose “f” të nenit 16, duhet të njoftojë Komitetin. Vendet anëtare në zhvillim do të njoftojnë Komitetin, jo më vonë se 120 ditë para mbarimit të datës së zbatimit. Vendet



anëtare më pak të zhvilluara do të njoftojnë Komitetin jo më vonë se 90 ditë para asaj date.

b) Njoftimi për Komitetin do të tregojë datën e re në të cilën vendi anëtar në zhvillim ose vendi anëtar më pak i zhvilluar pret të jetë në gjendje të zbatojë dispozitën në fjalë. Njoftimi do të tregojë, gjithashtu, arsyet për vonesën e pritur në zbatim. Arsye të tilla mund të përfshijnë nevojën për ndihmë dhe mbështetje për ndërtimin e kapacitetit të paparashikuar më herët ose ndihmë dhe mbështetje shtesë për të ndihmuar ndërtimin e kapacitetit.

2. Kur kërkesa e një vendi anëtar në zhvillim për kohë shtesë për zbatimin nuk tejkalon 18 muaj ose kërkesa e një vendi anëtar më pak i zhvilluar për kohë shtesë nuk tejkalon 3 vjet, anëtari kërkues ka të drejtën për një kohë të tillë shtesë pa veprimin e mëtejshëm të Komitetit.

3. Kur një vend anëtar në zhvillim ose vend anëtar më pak i zhvilluar konsideron që kërkon një zgjatje të parë më të gjatë se ajo e parashikuar në paragrafin 2 ose një zgjatje të dytë ose pasuese, ai do t'i paraqesë Komitetit një kërkesë për një zgjatje që përfshin informacionet e përshkruara në nënparagrafin 1/b jo më vonë se 120 ditë në lidhje me një vend anëtar në zhvillim dhe 90 ditë në lidhje me një vend anëtar më pak të zhvilluar para mbarimit të datës origjinale të zbatimit ose asaj date që zgjatet më pas.

4. Komiteti do të japë konsideratë dashamirëse për të dhënë kërkesat për zgjatje duke marrë parasysh rrethanat specifike të anëtarit që paraqet kërkesën. Këto rrethana mund të përfshijnë vështirësitë dhe vonesat në marrjen e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit.

Neni 18

Zbatimi i kategorisë B dhe kategorisë C

1. Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13, nëse një vend anëtar në zhvillim ose një vend anëtar më pak i zhvilluar, që ka përmbushur procedurat e përcaktuara në paragrafët 1 ose 2 të nenit 16 dhe nenit 17, dhe kur një zgjatje e kërkuar nuk është dhënë ose kur vendi anëtar në zhvillim ose vendi anëtar më pak i zhvilluar në rast të kundërt përjeton rrethana të paparashikuara që ndalojnë që zgjatja të jepet sipas nenit 17, vetëvlerëson që kapaciteti i tij për të zbatuar një dispozitë sipas kategorisë C

vazhdon të mungojë, ai anëtar do të njoftojë Komitetin për paaftësinë e tij për të zbatuar dispozitën përkatëse.

2. Komiteti do të krijojë menjëherë një grup ekspert, dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë pasi Komiteti merr njoftimin nga vendi anëtar në zhvillim ose vendi anëtar më pak i zhvilluar. Grupi ekspert do të ekzaminojë çështjen dhe do të bëjë një rekomandim për Komitetin brenda 120 ditëve nga krijimi i tij.

3. Grupi ekspert do të përbëhet nga pesë persona të pavarur që janë shumë të kualifikuar në fushat e lehtësimit të tregtisë dhe ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit. Përbërja e grupit ekspert do të sigurojë ekuilibrin ndërmjet shtetasve nga vendet anëtare në zhvillim me ato të zhvilluara. Kur një vend anëtar më pak i zhvilluar përfshihet, grupi ekspert do të përfshijë së paku një shtetas nga vendi anëtar më pak i zhvilluar. Nëse Komiteti nuk bie dakord mbi përbërjen e grupit ekspert brenda 20 ditëve nga krijimi i tij, Drejtori i Përgjithshëm, në këshillim me kryetarin e Komitetit, do të vendosë përbërjen e grupit ekspert në përputhje me kushtet e këtij paragrafi.

4. Grupi ekspert do të marrë në konsideratë vetëvlerësimin e anëtarit për mungesën e kapacitetit dhe do të bëjë një rekomandim për Komitetin. Kur merr në konsideratë rekomandimin e grupit ekspert në lidhje me një vend anëtar më pak të zhvilluar, Komiteti, sipas rastit, do të marrë masa që lehtësojnë fitimin e kapacitetit të qëndrueshëm të zbatimit.

5. Anëtari nuk do t'i nënshtrohet procedimeve sipas Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes me Mirëkuptim mbi këtë çështje që nga koha kur vendi anëtar në zhvillim njofton Komitetin mbi paaftësinë e tij për të zbatuar dispozitën përkatëse deri në mbledhjen e parë të Komitetit pasi ai merr rekomandimin e grupit ekspert. Në atë mbledhje, Komiteti do të marrë në konsideratë rekomandimin e grupit ekspert. Për një vend anëtar më pak të zhvilluar, procedimet sipas Mirëkuptimit në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes nuk do të zbatohen për dispozitën përkatëse nga data e njoftimit të Komitetit mbi paaftësinë e tij për të zbatuar dispozitën derisa Komiteti merr një vendim mbi çështjen, ose brenda 24 muajve pas datës së mbledhjes së parë të Komitetit të përcaktuar më sipër, cilado që është më herët.



6. Kur një vend anëtar më pak i zhvilluar humbet aftësinë e tij për të zbatuar një angazhim të kategorisë C, ai mund të informojë Komitetin dhe të ndjekë procedurat e përcaktuara në këtë nen.

Neni 19

Zhvendosja ndërmjet kategorive B dhe C

1. Vendet anëtare në zhvillim dhe vendet anëtare më pak të zhvilluara, që kanë njoftuar dispozitat sipas kategorive B dhe C, mund të zhvendosin dispozitat ndërmjet kategorive të tilla përmes dorëzimit të një njoftimi për Komitetin. Kur një anëtar propozon të zhvendosë një dispozitë nga kategoria B në kategorinë C, anëtari do të ofrojë informacionet mbi ndihmën dhe mbështetjen e kërkuar për të ndërtuar kapacitetin.

2. Në rast se kërkohet kohë shtesë për të zbatuar një dispozitë të zhvendosur nga kategoria B në kategorinë C, anëtari mund:

a) të përdorë dispozitat e nenit 17, duke përfshirë mundësinë për një zgjatje automatike; ose

b) të kërkojë një ekzaminim nga Komiteti për kërkesën e anëtarit për kohë shtesë për të zbatuar dispozitën dhe, nëse është e nevojshme, për ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit, duke përfshirë mundësinë e shqyrtimit dhe rekomandimit nga grupi ekspert sipas nenit 18; ose

c) në rastin e një vendi anëtar më pak të zhvilluar, çdo datë e re e zbatimit për më shumë se katër vjet pas datës origjinale të njoftuar sipas kategorisë B do të kërkojë miratimin nga Komiteti. Veç kësaj, një vend anëtar më pak i zhvilluar do të vazhdojë të mbështetet te neni 17. Kuptohet që ndihma dhe mbështetja për ndërtimin e kapacitetit kërkohet për një vend anëtar më pak të zhvilluar që zhvendos kështu.

Neni 20

Periudha e faljes për aplikimin e mirëkuptimit mbi rregullat dhe procedurat që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Për një periudhë prej dy vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e neneve XXII dhe XXIII të GATT 1994, siç shtjellohen dhe aplikohen nga Mirëkuptimi mbi Rregullat dhe Procedurat që rregullojnë zgjidhjen

e mosmarrëveshjeve nuk do të zbatohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kundrejt një vendi anëtar në zhvillim në lidhje me çdo dispozitë që anëtari ka caktuar në kategorinë A.

2. Për një periudhë prej gjashtë vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e neneve XXII dhe XXIII të GATT 1994, siç shtjellohen dhe aplikohen nga mirëkuptimi mbi rregullat dhe procedurat që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nuk do të zbatohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kundrejt një vendi anëtar më pak të zhvilluar në lidhje me çdo dispozitë që anëtari ka caktuar në kategorinë A.

3. Për një periudhë prej tetë vjetësh pas zbatimit të një dispozite sipas kategorisë B ose C, nga një anëtar i vendeve më pak të zhvilluara, dispozitat e neneve XXII dhe XXIII të GATT 1994, siç shtjellohen dhe aplikohen nga mirëkuptimi mbi rregullat dhe procedurat që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nuk do të zbatohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kundrejt një vendi anëtar më pak të zhvilluar në lidhje me atë dispozitë.

4. Pavarësisht periudhës së faljes për aplikimin e Mirëkuptimit mbi Rregullat dhe Procedurat që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, para se të bëjë një kërkesë për këshillime në bazë të neneve XXII ose XXIII të GATT 1994 dhe në të gjitha fazat e procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me një masë të një vendi anëtar më pak të zhvilluar, një anëtar do t'i japë konsideratë të veçantë situatës së veçantë të vendeve anëtare më pak të zhvilluara. Në lidhje me këtë, anëtarët do të ushtrojnë kufizimin e duhur në ngritjen e çështjeve sipas mirëkuptimit mbi rregullat dhe procedurat që rregullojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke përfshirë vendet anëtare më pak të zhvilluara.

5. Secili anëtar, sipas kërkesës, gjatë periudhës së faljes të lejuar sipas këtij neni, do të ofrojë mundësinë e përshtatshme për anëtarët e tjerë për diskutim në lidhje me çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit

1. Anëtarët donatorë bien dakord të lehtësojnë ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit për vendet anëtare në



zhvillim dhe më pak të zhvilluara mbi kushtet e rëna dakord në mënyrë bilaterale ose përmes organizatave ndërkombëtare të përshtatshme. Objektivi është të asistojnë vendet anëtare në zhvillim dhe më pak të zhvilluara për të zbatuar dispozitat e seksionit I të kësaj Marrëveshjeje.

2. Duke pasur parasysh nevojat e veçanta të vendeve anëtare më pak të zhvilluara, ndihma dhe mbështetja e synuar duhet të ofrohet për vendet anëtare më pak të zhvilluara, në mënyrë që t'i ndihmojnë ato për të ndërtuar kapacitetin e qëndrueshëm për të zbatuar angazhimet e tyre. Përmes mekanizmave përkatës të zhvillimit dhe të bashkëpunimit dhe në pajtim me parimet e ndihmës dhe mbështetjes teknike për ndërtimin e kapacitetit, siç referohet në paragrafin 3, partnerët e zhvillimit do të përpiqen të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për ndërtimin e kapacitetit në këtë fushë në një mënyrë që nuk kompromenton prioritetet ekzistuese të zhvillimit.

3. Anëtarët do të përpiqen të zbatojnë parimet e mëposhtme për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) të marrin parasysh kuadrin e përgjithshëm zhvillimor të vendeve dhe rajoneve marrëse dhe, aty ku duhet dhe është e përshtatshme, reformën në vazhdim dhe programet e ndihmës teknike;

b) të përfshijnë, aty ku duhet dhe është e përshtatshme, aktivitetet për të adresuar sfidat rajonale dhe nënrajonale dhe të nxisin integrimin rajonal dhe nënrajonal;

c) të sigurojnë që aktivitetet në vazhdim të reformës së lehtësimit të tregtisë të sektorit privat janë faktorizuar në aktivitetet e ndihmës;

d) të nxisin koordinimin ndërmjet dhe mes anëtarëve dhe institucioneve të tjera përkatëse, duke përfshirë komunitetet ekonomike rajonale, për të siguruar efikasitetin maksimal dhe rezultatet nga kjo ndihmë. Për këtë qëllim:

i) koordinimi, kryesisht në vendin ose rajonin ku ndihma do të ofrohet, ndërmjet anëtarëve dhe donatorëve partner dhe mes donatorëve bilateral dhe multilateral do të synojë të shmangë mbivendosjen dhe dublikimin në programet e ndihmës dhe papajtueshmëritë në aktivitetet e reformës përmes koordinimit të ngushtë të ndihmës teknike dhe ndërhyrjeve të ndërtimit të kapacitetit;

ii) për vendet anëtare më pak të zhvilluara, Korniza e Integruar e Zgjeruar për ndihmën e lidhur me tregtinë për vendet më pak të zhvilluara duhet të jetë pjesë e këtij procesi koordinimi; dhe

iii) anëtarët duhet, gjithashtu, të nxisin koordinimin e brendshëm ndërmjet zyrtarëve të tyre të tregtisë dhe të zhvillimit, në kryeqytete dhe në Gjenevë, në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe ndihmës teknike;

e) të nxisin përdorimin e strukturave ekzistuese të koordinimit në vend dhe rajonale si tryezat e rrumbullakëta dhe grupet e këshillimit për të koordinuar dhe monitoruar aktivitetet e zbatimit; dhe

f) të nxisin vendet anëtare në zhvillim t'i ofrojnë ndërtimin e kapacitetit vendeve të tjera anëtare në zhvillim dhe më pak të zhvilluara dhe të marrin në konsideratë aktivitetet e tilla mbështetëse, aty ku është e mundur.

4. Komiteti do të mbajë të paktën një seancë të dedikuar në vit, për:

a) të diskutuar çdo problem në lidhje me zbatimin e dispozitave ose nënpjesëve të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

b) të shqyrtojë progresin në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit për të mbështetur zbatimin e Marrëveshjes, duke përfshirë çdo vend anëtar në zhvillim ose më pak të zhvilluar që nuk merr ndihmë dhe mbështetje të përshtatshme për ndërtimin e kapacitetit;

c) të ndajë eksperiencat dhe informacionet mbi ndihmën dhe mbështetjen në vazhdim për ndërtimin e kapacitetit dhe programet e zbatimit, duke përfshirë sfidat dhe sukseset;

d) të shqyrtojë njoftimet e donatorit siç përcaktohet në nenin 22; dhe

e) të shqyrtojë operimin e paragrafit 2.

Neni 22

Informacionet mbi ndihmën dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit që do t'i paraqiten komitetit

1. Për të siguruar transparencën ndaj vendeve anëtare në zhvillim dhe vendeve anëtare më pak të zhvilluara mbi ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit për zbatimin e seksionit I, secili anëtar donator që asiston vendet anëtare në zhvillim dhe vendet anëtare më pak të zhvilluara me zbatimin e kësaj



Marrëveshjeje do t'i paraqesë Komitetit, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo vit pas kësaj, informacionet e mëposhtme mbi ndihmën dhe mbështetjen e tij për ndërtimin e kapacitetit që është disbursuar në 12 muajt e mëparshëm dhe, ku është e disponueshme, që është kryer në 12 muajt në vijim:²²

- a) një përshkrim të ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit;
- b) statusin dhe shumën e kryer/disbursuar;
- c) procedurat për disbursimin e ndihmës dhe mbështetjes;
- d) Anëtarin përfitues ose, kur është e nevojshme, rajonin; dhe
- e) agjencinë e zbatimit në anëtarin që ofron ndihmën dhe mbështetjen.

Informacionet do të ofrohen në formatin e specifikuar në aneksin 1. Në rastin e anëtarëve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (referuar në këtë Marrëveshje si "OECD"), informacionet e paraqitura mund të bazohen mbi informacionet përkatëse nga Sistemi Raportues Kreditor i OECD-së. Vendet anëtare në zhvillim që e deklarojnë veten e tyre në një pozicion për të ofruar ndihmë dhe mbështetje për ndërtimin e kapacitetit nxiten të ofrojnë informacionet më sipër.

2. Anëtarët donatorë që asistojnë vendet anëtare në zhvillim dhe vendet anëtare më pak të zhvilluara do t'i paraqesin Komitetit:

- a) pikat e kontaktit të agjencive të tyre përgjegjëse për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit të lidhur me zbatimin e seksionit 1 të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë, sipas rastit, informacione mbi pika të tilla të kontaktit brenda vendit ose rajonit ku ndihma dhe mbështetja do të ofrohet; dhe
- b) informacione mbi procesin dhe mekanizmat për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje për ndërtimin e kapacitetit.

Vendet anëtare në zhvillim që e deklarojnë veten e tyre në një pozicion për të ofruar ndihmë dhe mbështetje nxiten të ofrojnë informacionet më sipër.

3. Vendet anëtare në zhvillim dhe vendet anëtare më pak të zhvilluara që synojnë të

ndihmojnë veten me ndihmën e lidhur me lehtësimin e tregtisë dhe mbështetjen për ndërtimin e kapacitetit do t'i paraqesin Komitetit informacione mbi pikat e kontaktit të zyrave përgjegjëse për koordinimin dhe prioritizimin e kësaj ndihme dhe mbështetjeje.

4. Anëtarët mund të ofrojnë informacionet e referuara në paragrafët 2 dhe 3, përmes referencave dhe do të përditësojnë informacionet si të jetë e nevojshme. Sekretariati do të vërë publikisht në dispozicion informacione të tilla.

5. Komiteti do të ftojë organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale (si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, OECD-ja, Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin, OBD-ja, Komisionet Rajonale të Kombeve të Bashkuara, Bankën Botërore ose organet e tyre ndihmëse, dhe bankat e zhvillimit rajonal) dhe agjenci të tjera të bashkëpunimit për të ofruar informacionet e referuara në paragrafët 1, 2 dhe 4.

SEKSIONI III MARRËVESHJET INSTITUCIONALE DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Marrëveshjet institucionale

1. Komiteti mbi Lehtësimin e Tregtisë

1.1 Një Komitet mbi Lehtësimin e Tregtisë krijohet me anë të kësaj.

1.2 Komiteti do të jetë i hapur për pjesëmarrje nga të gjithë anëtarët dhe do të zgjedhë kryetarin e tij. Komiteti do të mblidhet sipas nevojës dhe do të parashikohet nga dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, por jo më pak se një herë në vit, me qëllim që t'u japë anëtarëve mundësinë për t'u këshilluar mbi çdo çështje të lidhura me operimin e kësaj Marrëveshjeje ose përparimin e objektivave të tij. Komiteti do t'i kryejë përgjegjësi të tilla siç i caktohen atij sipas kësaj Marrëveshjeje ose nga anëtarët. Komiteti do të krijojë rregullat e tij të procedurës.

1.3 Komiteti mund të krijojë organe ndihmëse siç mund të kërkohej. Të gjitha këto organe do t'i raportojnë Komitetit.

1.4 Komiteti do të zhvillojë procedurat për shpërndarjen nga anëtarët të informacioneve përkatëse dhe praktikave më të mira sipas rastit.

²² Informacionet e ofruara do të reflektojnë natyrën e drejtuar nga kërkesa e ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes për ndërtimin e kapacitetit.



1.5 Komiteti do të mbajë kontakt të ngushtë me organizatat e tjera ndërkombëtare në fushën e lehtësimit të tregtisë, si OBD-ja, me objektivin e sigurimit të këshillimit më të mirë të mundshëm për zbatimin dhe administrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe me qëllim për të siguruar që publikimi i panevojshëm i përpjekjes të shmanget. Për këtë qëllim, Komiteti mund të ftojë përfaqësuesit e organizatave të tilla ose organeve të tyre ndihmëse, për të:

- a) marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit; dhe
- b) diskutojë çështje specifike të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.6 Komiteti do të shqyrtojë operimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje pas katër vjetësh nga hyrja e saj në fuqi dhe në mënyrë periodike pas kësaj.

1.7 Anëtarët inkurajohen të ngrenë para Komitetit pyetje në lidhje me çështjet mbi zbatimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje.

1.8 Komiteti do të inkurajojë dhe lehtësojë diskutimet *ad hoc* mes anëtarëve mbi çështje specifike sipas kësaj Marrëveshjeje me synimin për të arritur menjëherë një zgjidhje të kënaqshme reciprokisht.

2. Komiteti Kombëtar mbi Lehtësimin e Tregtisë

Secili anëtar do të krijojë dhe/ose mbajë një komitet kombëtar mbi lehtësimin e tregtisë ose të caktojë një mekanizëm ekzistues për të lehtësuar koordinimin e brendshëm dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 24

Dispozitat përfundimtare

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “anëtar” konsiderohet se përfshin autoritetin kompetent të atij anëtari.

2. Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje janë të detyrueshme mbi të gjithë anëtarët.

3. Anëtarët do të zbatojnë këtë Marrëveshje nga data e hyrjes së saj në fuqi. Vendet anëtare në zhvillim dhe vendet anëtare më pak të zhvilluara që zgjedhin të përdorin dispozitat e seksionit II do të zbatojnë këtë Marrëveshje në përputhje me seksionin II.

4. Një anëtar që pranon këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi do të zbatojë angazhimet e saj të kategorisë B dhe C duke numëruar periudhat përkatëse nga data kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

5. Anëtarët e një bashkimi doganor ose një marrëveshjeje ekonomike rajonale mund të miratojnë qasje rajonale për të asistuar në zbatimin e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje duke përfshirë përmes krijimit dhe përdorimit të organeve rajonale.

6. Pavarësisht shënimit interpretues të përgjithshëm në aneksin 1A të Marrëveshjes së Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë, asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet sikur zbeh detyrimet e anëtarëve sipas GATT 1994. Veç kësaj, asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet sikur zbeh të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve sipas kësaj Marrëveshjeje mbi Barrierat Teknike të Tregtisë dhe Marrëveshja mbi Aplikimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare.

7. Të gjitha përjashtimet²³ sipas GATT 1994 do të aplikohen mbi dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Heqjet dorë që aplikohen për GATT 1994 ose çdo pjesë e tyre, të dhëna sipas nenit IX:3 dhe nenit IX:4 të Marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë dhe çdo ndryshim i saj, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen për dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

8. Dispozitat e neneve XXII dhe XXIII të GATT 1994, siç shtjellohen dhe aplikohen nga Mirëkuptimi në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes do të aplikohen për këshillimet dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç kur parashikohet ndryshe në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje.

9. Rezervimet mund të mos hyjnë në lidhje me secilën prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje pa miratimin e anëtarëve të tjerë.

10. Angazhimet e kategorisë A të vendeve anëtare në zhvillim dhe vendeve anëtarë më pak të zhvilluara bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 15 do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

11. Angazhimet e kategorisë B dhe C të vendeve anëtare në zhvillim dhe vendeve anëtarë më pak të zhvilluara të marra shënim nga Komiteti dhe bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje në pajtim me paragrafin 5 të nenit 16 do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

²³ Kjo përfshin nenet V:7 dhe X:1 të GATT 1994 dhe shënimi Ad i nenit VIII të GATT 1994.



ANEKSI 1
FORMATI PËR NJOFTIMIN SIPAS PARAGRAFIT 1 TË NENIT 12

Anëtari donator:

Periudha e mbuluar nga njoftimi:

	Përshkrimi i ndihmës teknike dhe financiare dhe burimet e ndërtimit të kapacitetit	Statusi dhe shuma e kryer/disbursuar	Vendi/rajoni përfitues (aty ku është e nevojshme)	Agjencia e zbatimit në anëtarin që ofron ndihmën	Procedurat për disbursimin e ndihmës

**VENDIM
Nr. 8/2016**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË
KONTROLLUAR ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR
ADMINISTRIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjeve dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore, me synim parandalimin e këtij fenomeni negativ për shtetin, qytetarët dhe bizneset dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të legjislacionit tatimor në administrimin e bazave të të dhënave shtetërore nga ana e administratës tatimore për periudhën 12.11.2013 – 7.12.2013.

2. Njohja dhe verifikimi i problematikës së ndërhyrjeve në sistemet tatimore, me qëllim përcaktimin e mënyrës së kryerjes së këtij veprimi, si dhe identifikimin e përgjegjësive nga organet apo personat zyrtar përkatës, me synimin për frenimin me mjete ligjore të shfaqjes së tij në të ardhmen.

3. Njohja me arsyet e mosfunksionimit të sistemeve tatimore për disa ditë, me qëllim parandalimin e kësaj problematike të dëmshme në të ardhmen.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim ndalimin përfundimtar të ndërhyrjeve të paligjshme në sistemet tatimore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtijshme ligjore.

V. Komisioni Hetimor Parlamentar përbëhet nga 11 deputetë, me përbërje si më poshtë:

- | | | | |
|----|-------------------|-------|------------|
| 1. | Arben Ristani | (PD) | Kryetar |
| 2. | Ervin Bushati | (PS) | Nënkryetar |
| 3. | Blerina Gjylameti | (PS) | Anëtare |
| 4. | Vasilika Hysi | (PS) | Anëtare |
| 5. | Antoneta Dhima | (PS) | Anëtare |
| 6. | Ervin Koci | (PS) | Anëtar |
| 7. | Përparim Spahiu | (LSI) | Anëtar |
| 8. | Jorida Tabaku | (PD) | Anëtare |



9. Florion Mima (PD) Anëtar
 10. Helidon Bushati (PD) Anëtar
 11. Sherefedin Shehu (PD) Anëtar.

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga miratimi i këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke venë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që, brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, t'i kalojë komisionit të gjitha aktet, dokumentet apo informacionet e hartuara apo të administruara gjatë veprimtarisë së Komisionit Hetimor “Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar më thellë fenomenin e ndërhyrjes dhe të bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore”, të ngritur me vendimet nr. 81/2014 dhe nr. 89/2015 të Kuvendit të Shqipërisë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDESKRYETARE
Valentina Leskaj

Miratuar në datën 11.2.2016

VENDIM
Nr. 111, datë 10.2.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.628, DATË 15.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE TË PROJEKTIMIT DHE NDËRTIMIT TË RRUGËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 1, 4 e 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1, të vendimit nr.628, datë 15.7.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1. Përgjashtimisht, për projektet që, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë përfunduar, janë paraqitur për miratim apo janë miratuar termat e referencës, si dhe kur është kryer studimi i fizibilitetit, për projektimin dhe zbatimin e tyre deri në përfundim të zbatohen dispozitat e vendimit nr.68, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, që kanë qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë